

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7740 E diel 16 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** *i* **Ditës**  
Të nderuar demokratë, zonja dhe zotërinj, zoti Berisha, zoti Bashadeputetë, ju përsërit në emrin tim dhe të Grupimit "Dhjetor 90"! Kam shumë ...  
Vijon në faqen 21

Nga BILIM AHMETAJ  
Fjala që s' mu dha në kuvendin e Partisë Demokratike  


**Opinion** *i* **Ditës**  
Më 10 dhjetor, liderët dhe përfaqësuesit e lartë të 164 vendeve të mbledhura në Marrakesh, Marok dhanë pëlqimin e tyre për "Kompaktin Global për ...  
Vijon në faqen 21

Nga JORGJI KOTE  
Pakti i Migracionit dhe përçar(t)jet nacionaliste  




Gazmend Oketa: Pse vendosa të rikthehem

## Kuvendi, Basha: PD-ja nuk vjen në pushtet me dhunë, duhet një elitë e re

7 kandidatë refuzojnë të garojnë për Këshillin Kombëtar. Duma: Të larguarit, flenë me pushtetin

VALENTINA MADANI

Demokratët mbledhën dje Kuvendin Kombëtar organin më lartë vendimmarrës të tyre, i cili do të votojë për lider-shipin e ri të partisë. Mbledhja e Kuvendit Kombëtar i hap rrugën zgjedhjes ekipit të ri të Lulzim Bashës ...  
Në faqet 2-3

## DREJTORI I INSTITUTIT TE SIGURIMEVE SHOQERORE: ORAR I ZGJATUR NE POSTA

# PENSIONISTET, SI NDAHET SHPERBLIMI PER FESTAT

Astrit Hado: Të hënën nis shpërndarja e parave sipas grafikut, përfitojnë 650 mijë pensionistët. Kush nuk e tërheq dot, e merr edhe gjatë 2019



(Në foto) Drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Astrit Hado. Pensionistët në sportelet e Postës Shqiptare



**TE RINJTE**  
"Dhori ik", studentët e Ekonomikut në protestë. Të hënën para Kryeministritë  
Në faqen 4

**ATENTATI**  
Eksplozivi në Vlorë, grujaja: Si shpëtuan unë dhe burri për një minutë nga vdekja  
Në faqen 7

**"MILOSAO"**  
Sa kriminelë pati Shqipëria sipas gjyqit special të Njerebergut?  
Suplement

**SHKOZET**  
Grabitja e blindit me 7.5 milionë lekë, arrestohen 2 policë privatë  
Në faqen 6

### KAMPIONATI BOTEROR



Aeronautistë të huaj në restorantin e 'Birra Korça': Këtu gjithëkoka shumë stil e shije  
Në faqen 8

Ministria e Financave publikon emrat, 3 muaj afat për të dorëzuar dokumentet

## 2800 të përndjekurit që marrin dëmshpërblimin

Lista nr. 3: Trashëgimtarët që përfitojnë këstin e tretë të parave

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë që nuk kanë marrë dëmshpërblimi e këstit të tretë duhet të dorëzojnë sa më parë në Ministrinë e Financave dokumentet që iu mungojnë në dosje për të mos humbur të drejtën për të marrë paratë. Burime zyrtare nga Ministria



e Financave bëjnë të ditur se janë mbi 2771 trashëgimtarë të ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist, të cilët duhet të plotësojnë dosjet për të filluar pagesat e këstit të tretë. Sipas të njëjtave burime mësohet se trashëgimtarët njihen si përfitues, por ...  
Në faqet 9-11

# KUVENDI I PD VOTIMI

### HAPËSIRA

Në kuvendin e PD dje kishte hapësirë për diskutime nga delegatët, nga disa deputetë, përfaqësues të bashkive dhe kryetarë të degëve të PD-së. Hapësirë për diskutim kishin edhe forumi rinor, ai i grave, përfaqësues të banorëve të "Astirit" dhe përfaqësues intelektualë.



### VOTIMI

Kreu i PD-së, Lulzim Basha dhe paraardhësi i tij, Sali Berisha votuan dje njëkohësisht në Kuvendin Kombëtar për zgjedhjen e 256 anëtarëve të rinj të Këshillit. I pari që iu drejtua qendrës së votimit ishte z.Berisha, por fill pas tij në radhë priti kreu demokrat Lulzim Basha.



### REZULTATI

Demokratët votuan dje për anëtarët e rinj të Këshillit Kombëtar. Delegatët votuan në 13 komisione të ngritura në ambientet e Pallatit të Kongreseve. Votuan 4740 vetë. Materialet u çuan në selinë e partisë ku u bë numërimi i fituesve pritet të shpallet sot nga PD-ja.

Lista, Godo: E vlerësoj, por do jetë keqkuptim. Harxhi: PD në protestë, jo në sallë

Valentina Madani

Demokratët votuan dje për anëtarësinë e re të Këshillit Kombëtar, i cili ka një pjesë të anëtarëve të garantuar automatikisht për shkak të funksioneve brenda partisë, ndërsa pjesë e listës së kandidatëve janë bërë edhe një pjesë e ish-deputetëve, me përjashtim të zërave më të fortë kundër Lulzim Bashës, si Majlinda Bregu, Astrit Patozi, Ridvan Bode dhe Genc Ruli. E vetmja ndër kritikët e Bashës, Jozefina Topalli, për shkak të funksionit si ish-kryetare e Kuvendit nuk mund të përjashtohet nga lista. Por ende pa nisur mirë punimet e Kuvendit Kombëtar të PD, gjatë të cilit do të zgjidhen drejtuesit e rinj në Këshillin Kombëtar të partisë, lista me 350 kandidatë e shpallur një ditë më parë ka pësuar largimet e para. Janë Erla Mëhilli, Edith Harxhi, Mimoza Hajdarmataj, Anila Godo, Arben Skenderi, Fabjan Topollaj dhe Valbona Mezini.

# Ikin 7 demokratë, rrudhet lista e kandidatëve për Këshillin Kombëtar

## Mëhilli: Arsyet personale, Kulluri e Mezini: Fasadë



### ARBEN RISTANI

"Pas zgjedhjes së kryesisë së re nuk mund të them se e shoh më të fortë PD, por mendoj se duhet përmblytur kjo hierarki. Partia është gati për sfidat. Partinë e bën më të fortë, shpirti, ideologjia. PD nuk është meçal, por lumë. Si gjithë lumenjtë që herë janë dhe të rrëmbyeshëm, por rëndësi ka që lëviz dhe nuk është pelg"- tha sekretari i përgjithshëm i PD

konsideron një vlerësim të madh, përfshirjen në listat e Këshillit Kombëtar të PD, ish-ministria Anila Godo shprehet se emri i saj në të është një keqkuptim. "Unë kam qenë dhe jam njeri me bindje të djathta, anëtare e PR që prej fillimit të demokracisë. Prej 10 vjetësh, për shkak të angazhimeve të shumta në jetën akademike e spitalore, nuk jam një person aktiv në politikë. Nuk kam kandiduar për anëtare të KK të PD. Ndaj emri im në listë, është me siguri një keqkuptim, edhe pse e konsideroj si vlerësim të madh."-shprehet zj.Anila Godo.



Kuvendi Kombëtar i PD-së

### Rikthimi në PD, Oketa: Çfarë më ktheu besimin të Basha

Një nga emrat më me peshë në PD, Gazmed Oketa, edhe pse u largua nga politika tashmë është rikthyer duke rifilluar me garën për anëtarë të Këshillit të ri të PD-së. Oketa tregoi dje se cilat ishin shtyesat që e rikthyen sërish atë në Partinë Demokratike. Në një bisedë telefonike për emisionin "Kjo Javë" të Nisida Tufës, Oketa deklaroi se rikthimi i tij në politikë dhe në PD lidhet me zhvillimet e fundit politike, por më kryesorja tha ai ishte protesta e studentëve, e cila shtoi ai ka shtuar shpresat e shoqërisë shqiptare. Ai komentoi, gjithashtu, edhe disa zëra, të cilët flasin se Gamend Oketa do të jetë kandidati për të sfiduar kreun e bashkisë së Durrësit, Vangjush Dakon në zgjedhjet lokale, por Oketa tha se nuk është e vërtetë një gjë e tillë. "Motivet që më bënë të rishikojmë do të përqipem t'i përmbledh shkurt. Ishin zhvillimet politike në vend. Lëvizja e studentëve dhe protesta më ktheu besimin se mund të ndryshojë situata, protesta e banorëve të "Astirit" si dhe ajo e Teatrit Kombëtar", tha Oketa.

### ARSYET

Ish-zëdhënësjja e PD-së Erla Mëhilli njoftoi dje se tërheqja nuk është aktuale, por një vendim që ishte marrë më herët për të mos rikandiduar më, pas dy mandateve radhazi. "Për këtë vendim timin njoftova edhe strukturat drejtuese të PD, por, sot (dje) e pashë emrin tim në listë dhe ndihem e detyruar që të sqaroj: "Për arsyet e mia personale kisha vendosur të mos kandidoja më për në KK të PD-së, pas dy mandateve radhazi e zgjedhur në këtë forum". Pas ish-zëdhënëses së Berishës, një tjetër demokrate u tërheq nga gara. Edhe Edith Harxhi, ish-zëvendës ministria e Punëve të Jashtme, njoftoi dorëheqjen. Sipas saj PD sot duhet të ishte në protestë dhe jo e mbyllur në sallë e marrë peng. "Unë tërhiqem nga gara për Këshillin Kombëtar të PD pasi si ish- studente dhjetori mbështes fuqimisht dhjetorin e dytë shqiptar dhe se PD duhet të ishte sot në protestë dhe jo e mbyllur në sallë dhe e marrë peng. Jam kundër grevëthyerjes!" shkruan Harxhi.

### AKUZAT

Edhe më i ashpër ka qenë në njoftimin e tij për t'u

## Prifti: Fjalë të drunjta e tjerre masive

Pedagogu në Kuvend: Dëgjova fjalime për Hënënjop për njerëzit, Në Kuvendin Kombëtar të PD-së, dje foli edhe pedagogu Rezart Prifti. Në fjalën e tij, Prifti nuk i kurseu kritikët për demokratët. Ai tha se në Kuvend kishte dëgjuar shumë fjalime të drunjta që nuk kanë lidhje me halltet e qytetarëve. "Atdheu është lakuriq. Në kohën e qoftëlarçut, për këtë shprehje, Trifon Xhagjika u dënua me vdekje. Edhe sot që flasim, atdheu është po lakuriq. Jam këtu për 3 arsye. Arsyet e parë ka të bëjë me atë që



Shumëkush më thoshin pse vjen këtu. Të shohësh telefonin tim, bëhet kërdia. Por, pikë së pari, unë besoj tek një shtet i vogël, pikë së dyti besoj në taksa të ulët

dhe pikë së treti besoj tek qytetaria. Tjetra, ti veshim rrobrot atdheut. Arsyetja tjetër pse erdha ka të bëjë me PD. Dëgjua këtu lloj e soj fjalimesh, fjalime të përgatitura për Hënënjop dhe jo për njerëzit që janë në shesh. Fjalë shumë të drunjta, një tjerre masive që nuk vete në veshin, e jo më në shpirtin e njeriut. Kjo organizatë ka nevojë për një alternativë. Dëgjova që tek ky vend s'funksionon asgjë. Dëgjova se shteti ka bërë atë dhe këtë, por nuk dëgjova se çfarë duhet të bëjë më shumë shtet"-tha Prifti.

tërhequr Edvin Kulluri. "Duke u nisur nga situata e rëndë në të cilën ndodhet PD, për shkak të 'leadership'-it të saj që vepron në kundërshtim të hapur me çdo parim demokratik, deklaroi tërheqjen nga gara 'farse' për anëtarë të Këshillit Kombëtar", shkruan ai në 'Facebook'. Ndërkohë që më i ashpër në qëndrimin e tij, është pedagogu Fabjan Topollaj, i cili

shprehet se z.Basha duhet të ndryshojë edhe emrin e partisë. Arben Skenderi mohoi se është pjesë e garës për Këshillin Kombëtar të PD-së. "Tërhiqem nga kjo pseudogarë! Kjo nuk është PD që duan demokratët, por një hibrid i quajtur "Republika e Re" e krijuar për qëllime personale dhe financiare të një grupi të vogël familjar. Opozita e vërtetë është sot në shesh".

shkruan Skenderi. **ISH-MINISTRIA** Ish-ministria e Shëndetësisë Anila Godo, emri i së cilës ka qenë në listën e kandidatëve për Këshillin Kombëtar të PD, sqaroi se ajo nuk ka aderuar asnjë herë për këtë post. Në një komunikim të shkurtër për mediat Godo shkruan se emri i saj në listën e gjatë me siguri është një keqkuptim. Edhe pse e





**ALBANA VOKSHI**  
 "Si nënë e dy vajzave të mia të vogla, ju falënderoj që po u tregoni shqiptarëve se nuk pritët lëmshë për të drejta themelore, por luftohet pa kompromis për to. Faleminderit për rikthimin e asaj çka kishte humbur prej vitesh në Shqipëri: shpresë!" - u shpreh Vokshi.



**"RRËZIMI"**  
 Fjalimi i gjatë që Lulzim Basha mbajti dje përpara kuvendit, për pak sa nuk u mbyll me një incident. Në fund të fjalimit, mes ovacioneve dhe duartrokitjeve të të pranishmëve në sallë, teksa përshëndeti me dy gishtat lart, Basha për pak sa nuk u rrëzua pasi nuk e pa shkallën që i duhej të zbrishte.



**EDI RAMA**  
 Kryeministri Edi Rama duket se nuk i shpëton asnjë moment pa ironizuar z.Basha. Ai i "kushtoi" një story në Instagram-in e tij liderit demokrat, i cili pësoi një incident të vogël pas fjalës së tij në Kuvendin e PD. Rama përfitoi nga rastit për ta ironizuar. "Pse më e keni zgju herët sot (dje), po është gjynof mër", shkruan Rama.



Valentina Madani

**D**emokratët mbledhën dje Kuvendin Kombëtar organin më lartë vendimmarrës të tyre, i cili do të votojë për lidhshimin e ri të partisë. Mbledhja e Kuvendit Kombëtar i hap rrugën zgjedhjes ekipit të ri të Lulzim Bashës me të cilin ai do të dalë para votuesve për zgjedhjet lokale dhe zgjedhjet e përgjithshme. Përpara 4500 delegatëve të thirrur në Kuvendin e PD për të votuar 170 anëtarët e rinj të Këshillit Kombëtar, z.Basha foli për një elitë të re politike që i duhet vendit, përmes së cilës tha se mund të vijë edhe ndryshimi i shqiptarëve. Ndaj dhe sfida e radhës për të është hapja dhe afrimi i të rinjve në Partinë Demokratike. "Duhet një brez i ri politik. Duhet një elitë e re e vendit, e aftë për këtë aspiratë ndryshimi të shqiptarëve. Ne duhet të krijojmë kushtet. Duhet të ndërtojmë rrugën për këtë kalim të madh të përgjithshëm të drejtimit të vendit tek një brez i ri në politikë, ekonomi dhe shoqëri", theksoi z.Basha. Jashtë ftesës nuk la as të vjetrit, ata që më së shumti e kanë kritikuar për mënyrën sesi po drejton PD dhe disfatat e njëpasnjëshme të zgjedhjeve. Duke mos u mohuar kontributin e dhënë, u kujtoi se në partinë që ai drejton nuk ka pushtet të përgjithshëm. "Kontributi nuk do të thotë të kesh post, dhe aq më pak një post të përjetshëm në PD apo në pushtet. Kontribut do të thotë të punosh dhe mbështetësh misionin dhe veprimtarinë e PD-së. Në qeverisje dhe në opozitë, kur je anëtar i thjeshtë apo drejtues i lartë. Ata mund të ndihmojnë PD duke u kthyer në misionarë, në ambasadorë të PD-së, duke propaganduar idetë dhe vlerat e PD-së. Ata mund të ndihmojnë PD-në duke u kthyer në mentorë për demokratët e rinj. Pa asnjë dyshim, PD ka vend edhe për të gjithë ata që e kritikojnë atë nisur nga parimet dhe vullneti dashamirës për forcimin e saj. Pasi një dyshim, PD ka nevojë për kritikë, ka nevojë për mendimin ndryshe, ka nevojë për debat. Pa mendim ndryshe, nuk mund të ketë Parti Demokratike. Të gjithë ata që sot duan të kontribuojnë në PD, nuk kanë nevojë të jenë dakord me çdo gjë që bën PD, dhe janë të mirëpritur njësoj që të jenë pjesë e saj. Për të gjithë ata unë kam vetëm një ftesë: Ejeni

**Kthim në PD, Biberaj: Shqipëria ka nevojë për opozitë më të fortë**

Një nga emrat me kontribut historik në Partinë Demokratike, Aleksandër Biberaj deklaroi për dje "News 24" se ai u rikthye në PD me ftesë të kreut Lulzim Bashës. Ai përmendi se në karrierën e tij politike ka investuar shumë në politikë dhe konkretisht tek PD. "Kam investuar shumë vite në politikë dhe në PD, aq më tepër kur Shqipëria sot ka nevojë dhe e shoh veten në familjen time politike. Kontributi për demokraci dhe për Shqipërinë është parësor në krahasim me të gjithë të tjerat. Iu bëj thirrje intelektualëve që t'i bashkohen PD, pasi sa herë që Shqipëria ka pasur nevojë, Partia Demokratike ka bërë ndryshim. Është momenti më i përshtatshëm që të bashkohemi për të integruar Shqipërinë në BE si kemi ëndërruar në dhjetori të vitit '90' dhe siç kemi luftuar edhe 28 vite për interesin e Shqipërisë dhe shqiptarëve. Unë jam larguar nga PD kur ajo ishte në pushtet, sot PD është në opozitë. Në Shqipëri ka sot nevojë për një opozitë më të fortë, demokratike dhe më të organizuar, për një opozitë që shpallë një program më të mirë për të gjithë shqiptarët", tha Biberaj.

Kreu i PD-së mesazh kritikëve: Pushteti i përjetshëm, s'është kontribut në PD

# Kuvendi, Basha: PD s'do vijë kurrë në pushtet me dhunë e kufoma

"Koha për ndryshim, elitë të re politike"



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje në mbledhjen e Kuvendit Kombëtar

bëhuni pjesë nga afër, të gjitha dyert dhe të gjitha mendjet janë të hapura për ju", deklaroi kreu i PD-së.  
**THIRRJA**  
 Kreu i PD-së iu drejtua të rinjve që u janë bashkuar në këto ditë të vështira për vendin, kur, siç tha "krimi qeverisje vendin" dhe "arroganca mbizotëron" duke lënë në hije vlerat dhe parimet demokratike, të cilët i falënderoi në veçanti për përpjekjet e tyre ndër vite për mbrojtjen e demokracisë në vend. Basha falënderoi studentët dhe qytetarët që protestojnë kudo

për çdo ankesë dhe padrejtësi, sikurse edhe shprehu "respekt për mediet që raportojnë përditë nga çdo zhvillim". "Me kryengritjen e saj, rinia studentore na ndërjegjësoi për problemet më të mëdha me të cilat ndeshet shoqëria jonë. Koha ka ardhur për të thirrur në veprim rininë, e cila duket se do të jetë në larësinë e durimit që kërkohet koha. Ne jemi për një politikë ndryshe. Prej gati një shekulli, politika ka qenë pengesë për jetën shqiptare, më shumë ndarje sesa bashkim, ndërkohë që sot kemi nevojë për një politikë

**DEKLARATA**  
 "PD nuk do të vijë kurrë në pushtet mbi kufoma. PD nuk do të vijë kurrë në pushtet me mjet tjetër përveçse me zgjedhje. Demokratët nuk e duan pushtetin duke shkaktuar drama dhe kosto shoqërore, duke nxitur përçarjen e përplasjes mes shqiptarësh. Ne nuk jemi burravecë që t'i përdorin shqiptarët e ndershëm e të pafajshëm si mish për top për të ardhur në pushtet", tha z.Basha.

për liri, demokraci dhe europianizëm". Nga thirrja "E duam Shqipërinë si gjithë Europa", - u shpreh Basha, - kanë kaluar vite, janë ndërruar breza, por koha dhe ndryshimet që ajo sjell, bëjnë që Shqipëria e sotme të mos krahasohet me atë të para 30 viteve, edhe pse jemi ende larg potencialit tonë kombëtar.  
**AKUZAT**  
 Qeverisja e Edi Ramës dhe akuzat ndaj kryeministrit zunë jo pak vend në fjalimin e kreut të opozitës, por përpara të vetëve Basha ripërsëriti qëndrimin se në pushtet demokratët nuk do të vijnë me dhunë. "Pas Enver Hoxhës ai është njeriu më i dëmshëm që ka patur ndonjëherë Shqipëria. Largimi i tij nga pushteti është i domosdoshëm për të ndaluar fundosjen e Shqipërisë. Largimi i tij nga pushteti është hapi i parë drejt ndryshimit të drejtimit të vendit. PD nuk do të vijë kurrë në pushtet mbi kufoma. PD nuk do të vijë kurrë në pushtet me mjet tjetër përveçse me zgjedhje. Demokratët nuk e duan pushtetin duke shkaktuar drama dhe kosto shoqërore, duke nxitur përçarjen e përplasjes mes shqiptarësh. Jeta dhe mirëqenia e çdo shqiptari është më e shtrenjtë se çdo karriqe e tepsi. Ne nuk jemi burravecë që t'i përdorin shqiptarët e ndershëm e të pafajshëm si mish për top për të ardhur në pushtet. Por unë jam i bindur se për të rrezuar Edi Ramën nuk ka nevojë për dhunë. Edi Rama nuk rrezohet nga pushteti duke e goditur një herë me top. Edi Rama rrezohet duke i rezistuar atij përditë, duke kundërshtuar përditë keqeverisjen e tij. Duke protestuar për ditë", u shpreh z.Basha. Kundërshtarin e tij politik e akuzoi se ka objektiv të vetin jo vetëm përçarjen e demokracisë por edhe atë të shqiptarëve.

## Të larguarit nga PD, Duma: Zgjodhën pushtetin, flenë me mëkatën e tradhtisë

Deputetja e demokrate, Grida Duma gjatë punimeve të Kuvendit Kombëtar të PD-së kritikoi dje të larguarit nga partia, duke thënë se ata zgjedhën rrugën e pushtetit. "Në mundësi kjo Shqipëri bëhet, është vend i pasur, por po ta shikosh nga dritarja ajo është mjerim, kur e pyetën Çaplinin nga çfarë ke frikë, tha nga varfëria, por nga ajo që

është në turp në raport me botën. E nisa dhe do e vazhdoj me demokratë se është e rëndësishme të themi që ju nuk keni vajtur vetëm luftën e kundërshtarit, keni parë demokracitë drejtuar drejt pushtetit, kanë zgjedhur rrugën tjetër, duhen ndërruar mundësitë e drejta që të flihet gjumë pa mëkatën që ke tradhtuar tëndin", - u shpreh Duma.

emërrohem plotësisht është që të plakem i varfër: 645 mijë pensionistë që janë prinëditit dhe gjyshtërit tanë marrin pension më të ulët në Ballkan, ajo ndihma që ne na oshtin ironia qeverisëse që thonë janë dembelë shqiptarët, ndaj mbeten të varfër, se kur shkon në Evropë janë më të mirët dhe të integruarit e na e ngrënë nderin edhe pse vendi ka ulur kokën sot dhe

# PROTESTAT STUDENTËT

'Të hënën protestë masive', studentët thirrje qytetarëve: Bashkohuni me ne

## 'Dhori ik', studentët: Duan të na manipulojnë, por s'tërhiqemi

### Të rinjtë mirëpresin banorët e "Astirit"

Valentina Madani

Studentët paralajmërojnë protestë masive ditën e hënë ndërsa u bëjnë thirrje qytetarëve në mbarë vendin që të bashkohen me ta. Në ditën e 11-të të protestës para Kryeministrit, studentët theksuan dje se nuk tërhiqen nga kërkesat e bëra tashmë publike, për të cilat kërkojnë vetëm plotësim nga ana e Kryeministrit dhe jo dialog mes palëve. Këshillat Studentorë dolën me një deklaratë dhe kërkojnë që të hënën studentët të kenë mbështetje nga të gjithë për të pasur sa më shumë masivitet. Në deklaratën e tyre shkruhet se protesta si zakonisht do të nisë në orën 10:00. Moti me shi nuk i pengoi as dje studentët që të vijojnë më protestën e tyre. Të vendosur para Kryeministrit, studentët kërkuar dorëheqjen e dekanit Dhori Kule. Mësohet se studentët e Ekonomikut kishin kërkuar takim me Kulen, por ky i fundit nuk ka shkuar. Ai kishte propozuar që studentët të ngrinin një përfaqësi prej 20 vetash dhe do t'i priste ata në takim pasditen e sotme për t'i dëgjuar lidhur me kërkesat. Por studentët refuzuan dhe mësohet se në takim, në ambientet e Fakultetit Ekonomik kanë qenë një numër i konsiderueshëm. Nisur nga prezenca masive e studentëve, dekanit Dhori Kule nuk ka shkuar në takim. Ky veprim i tij ka sjellë reagimin e studentëve, të cilët i kanë kërkuar dorëheqjen. "Jam studente e Ekonomikut. Ne kërkuam një mbledhje me dekanatin për të diskutuar problematikën. Ne pritëm, por nuk na erdhi asnjë. Ne erdhëm këtu dhe po protestojmë. Fakulteti digjet dhe Dhori krihet. Duhet të vijë dhe të mbajë përgjegjësi"- tha një studente duke e shoqëruar në kor me thirrjet "Dhori Kule ik". Studentët u shprehën se ka përpjekje për t'i manipuluar ato në kauzën e tyre, e cila dje hyri në ditën e 11-të. "Kanë filluar të bëjnë thirrje për dialog nëpër studentët në ndryshëm. Duan të na manipulojnë, nuk është aspak morale që të sabotojnë kauzën tonë", tha një student.

#### MBËSHTETJA

Grupit të studentëve të mbledhur përpara Kryeministrit dje u bashkuan edhe banorët e "Astirit". Ndryshe nga disa ditë më parë, kur studentët të mbledhur para Ministrisë së



#### ARTAN FUGA

"Midis rinisë, mes politikave qeveritare, por edhe institucioneve ka një humbje besimi. Nuk mjafton vetëm një dialog Rama-student, unë propozoj një kuvend ku të marrin pjesë shumë aktorë për kanë vendimarrje në arsim, që të shfrytëzohet për të gjetur shumë problematika", tha akademiku dhe profesori, Artan Fuga në "News 24".



Protesta e studentëve të Kryeministria

### Kryeministri: Po na bëhet dialogu burrë

## Protesta, Rama: Studentët mbahen peng nga një grusht njerëzish

Kryeministri Edi Rama vazhdon të përsërisë thirrjen për dialog me studentët. Në rrjetet sociale, ai publikoi një fotografi nga protesta që u zhvillua dje përpara godinës së Kryeministrit. Sipas Ramës, protesta e studentëve po mbahet peng nga disa persona, që sipas tij, bëjnë thirrje kundër dialogut të Kryeministrit me studentët. "Një grusht njerëzish që përsërisin qorrazi avazin kundër dialogut, mbajnë peng mijëra studentë që duan dhe meritojnë jo vetëm adresimin e 8 pikave, po një transformim të thellë brenda universitetit, përmes një pakti me qeverinë! Historia tregon për shumë raste kur dialogut i janë trembur qeveritë, po s'ka bërë vaki kurrë që t'i tremben studentët dhe studentët sot, në fakt, nuk i tremben



dialogut, po presioneve kundër dialogut, sharjeve e fyerjeve ndaj kujtdo që kërkon dialog, të cilat porositen nga partitë përmes studentësh që ia kanë shitur shpirtin politikës më të mbrapshtë. Sidoqoftë farsa e kësaj barrikade absurde kundër dialogut, s'ka për të zgjatur sa ka zgjatur. Dialogu do zhblokohet. Arsyja do fitojë dhe së bashku ne do të hapim një kapitull të ri për Universitetin", shpre-

het z.Rama. Po dje z.Rama publikoi një foto në Instastory, ku një qytetare kërkon një emër për djalit të fillojë me shkronjën 'D', ndërsa dikush komentoi 'Dialog'. Rama ka përfutur nga kjo situatë dhe i ka bërë sërish apel studentëve që të pranojnë të bisedojnë me të për kërkesat e tyre. "Po hë pra do flasim se po na bëhet Dialogu burrë?", shkruan Rama.

për prishjen e ndërtimeve të paligjshme në zonën e "Astirit", të prekura nga projektet e "Unazës së madhe". Rreth orës 11:00 një grup qytetaresh u bashkua protestës së studentëve. Në këtë tubim morën pjesë edhe familjarët e studentëve, të

cilët u solidarizuan me kauzën e të rinjve. "Qytetarë, të rinj çohuni nga kafja, e jani në shesh të protestoni bashkë me ne. Të tregojmë që jemi të bashkuar. Kjo kauzë është për të gjithë", bëri thirrje njëri prej të rinjve në protestë.

### Kryemadhi: Harroni kartën e partisë, të hënën, të gjithë te studentët

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi nga një takim me strukturat e partisë në Durrës bëri thirrje që të gjithë të bashkohen të hënën me protestën e studentëve. Në fjalën e saj, Kryemadhi tha se studentët nuk pranojnë të negociojnë, sepse e dinë se shefi i qeverisë këto takime i konverton në para dhe në vende pune. "Çdo negociatë është marrje e frymës për ta. Nuk ka si të negociojnë, sepse në parlament i kishte kërkesat, por nuk mori mundimin t'i shfletojë. Erdhi si rezultat i ekonomive të shqiptarëve, erdhi si rezultat i përqendrimit të ekonomisë në duart e 5 njerëzve. Të hënën të gjithë t'u bashkoheni studentëve në Tiranë, pa flamur partiakë, pa kartë anëtarësie, se ndryshe do të jenë shumë vonë për ta, për ne dhe për të gjithë Shqipërinë. Secili nga ju të këtë edhe dhjetë vetë me vetë", tha Kryemadhi. Edhe në Lushnje, në një tjetër takim me strukturat e LSI, Kryemadhi thirrje që të gjithë anëtarëve të LSI-së kudo që janë që të lënë kartat e anëtarësisë, të marrin flamurin kombëtar dhe t'i bashkohen ditën e hënë protestës së studentëve. "Këtë mësim të madh që studentët shqiptarë ia dhanë politikës,



#### PETRIT VASIL

"Edi Rama kjo çingje e lodhur, që përdridhet përpara celularit. Rama ia ka shitur shpirtin dhe të tjerat... llumit të këttë vendi. Ndërsa studentët janë pasqyra ku del Rama lakuriq si një çingje e vërtetë e hajdutërisë. Boll u përdrode çingje, hiqja paratë oligarkëve dhe jepua studentëve", -tha z. Vasil.

ne nuk duhet ta humbasim, por duhet ta bëjmë tonën, mënyrë të tillë që të kemi forcën, të kemi guximin, të kemi zemrën e atyre studentëve, të përballlemi me këtë të keqe kaq të madhe. Sot unë kam qenë në Durrës, në Kavajë, kam pasur disa takime të tjera. Nesër përsëri do të vazhdoj në Korçë, Pogradec, Përrenjas, Elbasan e kudo, jo për t'i bërë thirrje shqiptarëve. Por do dal për t'i bërë thirrje të gjithë anëtarëve të LSI kudo që janë, të harrojnë kartën e partisë dhe të marrin flamurin kombëtar për t'u bashkuar të hënën me studentët", -tha znj. Kryemadhi.





Grupi Parlamentar i PD bashkohet me banorët që preken nga projekti i Unazës së Re

# Banorët e "Astirit" në protestë: S'tërhiqemi, mos prishni shtëpitë

## Basha: Rama me 5 oligarkë po vjedh Shqipërinë

Kryetari i PD-së, Lulzim Basha dhe grupi i Partisë Demokratike kanë shkuar në mbështetje të protestës së banorëve të Unazës së Re, të cilët kundërshtojnë me forcë projektin.

Ai iu bëri thirrje të gjithë shqiptarëve të bashkohen me protestën e studentëve. Basha tregoi mes tjerash se tek projekti i Unazës së Re ka edhe një aferë të re korruptive, të cilën PD po e shqyrton dhe në ditën në vijim tha se do të bëhet publike. "Protestat nga më ato madhështoret tek studentët, ato të unazës, tek teatri janë shenja e qartë se ku ndodhet vendi. Ka dy ditë që banorët e Unazës së Re kanë protestuar me studentët. Edi Rama po luan me fatin e të rinjve. Mos t'i lëmë fëmijët tanë në dorën e tij. Ftoj të gjithë qytetarët t'u bashkohen studentëve. Ligji i arsimit të lartë është burim i krizës. Rama financoon më shumë për luksin e vet, se sa investon për arsimin. Ftesa ime nga Unaza, është për çdo shqiptar: T'i bashkohen masivisht protestës së tyre. Është koha që të gjithë shqiptarët ta bëjnë këtë. PD ka ndihmuar për padinë që banorët kanë çuar në prokurori. PD ka ndihmuar banorët në këtë padinë me ekspertët e saj. Planin Ramës ia kanë prishur studentët, ndaj është sulur për t'i mbrojtur veprimet e tij, por s'ka për t'ia dalë dot. Të gjitha tenderët fitohen me garë të dyshimtë. Tek unaza e re ka edhe një aferë tjetër dhe ne po merremi me shqyrtimin e dokumenteve, ne do t'i bëjmë publike në ditët në vijim. Ne jemi në radhë të parë në mbështetje të banorëve dhe studentëve, jam i bindur se Edi Rama do të largohet një orë dhe më parë", tha Basha.

**DEKLARATA E BASHES**  
Cdo projekti i Autoritetit Rrugor Shqiptar, që nga Afrim Qëndro dhe komandohet nga Rama, shikoni se çfarë ndodh; të gjitha tenderët fitohen në kushte dyshimta, afër çmimit tavan, në shumicën e rasteve në konkurrencë false si këtu, me kompani që njëra tërhiqet për të lejuar që ta marrë ajo që ka caktuar Rama. Ndërkohë që Rama ka përfshirë ARRSH-në dhe institucionet shtetërore në skemën më të madhe korruptive në Ballkan të projektit të PPP-ve



Protesta e djeshme e banorëve të "Astirit"

mentëve që tregon se plani urbanistik ka ndryshuar këtu për të favorizuar krimin e organizuar që do të ndërtojë pallate shumëkatëshe. Menjëherë pasi të kemi analizën e plotë dhe disa dokumente shtesë do t'i bëjmë publike.

Afera e aferave është që ne sot kemi një qeveri grabitqare, e cila nuk ka asnjë politikë, politika e vetme e tyre është vjedhja dhe përpos kësaj cinizmi dhe tallja. Ka 11 ditë që tallet me studentët, ka 6 javë që tallet me banorët dhe ka ardhur koha që shqiptarët ta kuptojnë se e vetmja mundësi për t'i dhënë fund kësaj situatë është bashkimi dhe qëndresa në një protestë kombëtare pa pushim.

një miliardë euro që tani ka shkuar në 2.2 miliardë euro. Kjo është një skemë e hapur tjetër me të cilën ne po merremi me shqyrtimin e doku

mentëve ndërsa këtu tek Unaza ka edhe një aferë tjetër me të cilën ne po merremi me shqyrtimin e doku

**KRYETARI I PD**

"Afrim Qëndro është masha e Edi Ramës dhe përmes tij është zbuluar një aferë ndërkombëtare e pastrimit të parave të pista me hapjen e kompanisë në SHBA me falsifikim të letrave zyrtare", -deklaroi Lulzim Basha.



**"Ky çmim u shkollon arbëreshëve tanë të dashur"**

### Itali, Presidenti Meta merr çmimin "Politikani ndërkombëtar i vitit 2018"

Presidenti i Republikës, Ilir Meta u vlerësua dje me çmimin "Politikani ndërkombëtar i vitit 2018" nga Fondacioni "Foedus". Kreut të shtetit shqiptar iu akordua ky çmim me motivacionin "Për promovimin dhe forcimin e marrëdhënieve dhe miqësisë mes Shqipërisë dhe Italisë".

Në ceremoninë gala të zhvilluar në Romë, me temë "Një dhuratë për një buzëqeshje", presidenti i Fondacionit "Foedus", z.Mario Baccini, duke i dorëzuar çmimin i prestigjioz Presidentit Meta theksoi se ky vlerësim u jepet çdo vit atyre personaliteteve italiane dhe të huaja, të cilët kanë spikatur në fushat e tyre.

Presidenti Meta duke falënderuar Fondacionin "Foedus" për vlerësimin e bërë ndaj tij u shpreh ndër të tjera se: "Ky çmim u shkollon mijëra shqiptarëve që jetojnë dhe punojnë në Itali. Ky çmim u shkollon arbëreshëve tanë të dashur, të cilët lidhin dy popujt tanë në mënyrë unike prej 500 vjetësh, por edhe mijëra italianëve që punojnë dhe jetojnë në Shqipëri prej vitesh. Edicioni i 18-të i Fondacionit Tuaj titullohet "Një dhuratë për një buzëqeshje" ndaj dhe unë duke ju falënderuar për vlerësimin dua t'ju kujtoj thënien e një shqiptareje të madhe, Shën Nënë Tereza, e cila ka thënë se pagja fillon me një buzëqeshje", - theksoi Presidenti Meta.

Çmimi i Fondacionit "Foedus" iu akordua, gjithashtu, edhe UNICEF-it, NEUROMED Italia, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë italiane, Franco Gabrielli, si dhe këngëtarit të famshëm italian Fausto Leali.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

**SHPLLJE VENDI VAKANT**

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikë dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikë dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit" shpall (një) vend vakant për "Drejtor" në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

**KËRKESAT E POSAÇËM TË POZICIONIT:**

- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" për Ekonomi.
- b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c. Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në nivel drejtues e menaxherial.

**KUSHTE TË PËRGJITHSHME:**

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certifikatë Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 12 dhjetor deri më 31 dhjetor 2018 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 31 dhjetor 2018, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 12 dhjetor deri më 31 dhjetor 2018 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmim nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional në gjuhën shqipe, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të notuarur. Diplomata që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për rrijshimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuara me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.

**Gjykata vendos "Detyrim paraqitje"**

**Vrasja në ish-Bllok, lirohet Fabiol Alushi, miku i Ervin Matës**

**TIRANË** - Gjykata e Tiranës ka dhënë masën e sigurisë 'Detyrim paraqitje' për Fabiol Alushin, i cili u arrestua tri ditë më parë për vrasjen e ndodhur më 4 tetor të këtij viti në zonën e ish-Bllokut. Në seancën e djeshme gjyqësore, prokuroria kërkoi masën e arrestit me burg me afat 30 ditor për 42-vjeçarin, por kjo kërkesë u rrëzua nga gjyqtari Artan Gjermani, i cili e la të lirë. Vetë Alushi ka mohuar të ketë qenë i përfshirë në ngjarjen e

ndodhur në lokalit "Monopoli ku mbeti i vranë 28-vjeçari Fabian Gaxha dhe u plagosjen e Ervis Martinajt dhe Eljon Hato. Ai u mor në pyetje pasi u vetëdorëzua në polici, ndërsa pohoi se nuk kishte patur më parë konflikt me grupin e Ervis Martinajt. 42-vjeçari njihet si mik me Ervin Matën dhe Merviol Bilon, komandon që dyshohet se qëlloi në drejtim të grupit të Martinajt. Alushi akuzohet për veprat penale: "Vrasje në rrethana të tjera cilësuese", e kryer në bash-



këpunim dhe "Armëmbajtje pa leje". Ndërkohë, vijojnë të jenë në kërkim në lidhje me këtë ngjarje: Ervin Mata, i cili dyshohet se është arratisur jashtë vendit; Merviol Bilo, i cili i ka shpëtuar një operacioni policor pak ditë më parë; biznesmeni Eldi Dizdari si dhe një ish-efektiv policie. Ngjarja dyshohet të ketë si shkak prishjen e pazareve të drogës mes Ervin Matës dhe biznesmenit Eldi Dizdari.

**I sekuestrohen dhe cigare kontrabandë**

**I gjenden në trup 80 mijë euro të padeklaruara, kapet tregtari kinez**

**TIRANË** - Një shtetas kinez, por me banim të përkohshëm në Tiranë është prangosur në aeroportin e Rinasit, pasi gjate kontrollit iu gjeten të fshehura në trup 80 mijë euro, 76 mijë lekë dhe 2900 yuan kinez të padeklaruara. "Policia Kufitare e Rinasit në zbatim të detyrave të përcaktuara në Planin e Masave të përbashkët me Degën e Doganës Rinas, kanë ushtruar kontrollin të përbashkët në pasagjerët e linjave ajrore me

qëllim parandalimin dhe goditjen e paligjshmërisë. Si rezultat i kontrollve është përzgjedhur për kontroll në vijën e dytë 43-vjeçari kinez J.L., lindur në Kinë dhe me banim të përkohshëm në Tiranë (me leje qëndrimi), të cilin gjatë kontrollit në bagazhin e dorës dhe në trup iu gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale shumat e padeklaruara", bëri me dije policia. Gjithashtu, shtetasit në fjalë, gjatë kontrollit iu sekuestruan edhe 9 steka paketash



cigare pa pullë fiskale. Në përfundim të veprimeve 43 vjeçari u arrestua në flagrancë për veprat penale: "Kontrabandë me mallra që paguhet akcizë" dhe "Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë", parashikuar 179/a i Kodit Penal. Sipas policisë gjatë vitit 2018 janë evidencuar dhe goditur 13 raste të mosdeklarimit të vlerave monetare në kufi.

Të arrestuarit: Jemi të pafajshëm, s'mund të ndërhyjmë se na vunë armët në kokë

**Grabitja e blindit me 7.5 mln lekë, pranga 2 policëve privatë për shpërdorim detyrë**

*Blutë: Fejzi Saka dhe Astrit Gjata s'vepruan në momentin kur 3 personat e maskuar u morën paratë*

Klodiana Haxhija

**DURRËS**

Dy policë privatë që shoqëronin makinën që u grabit mbremjen e së premtes në Shkozët kanë përfunduar në prangë dhe policisë së Durrësit. Bëhet fjalë për shtetasit Fejzi Saka dhe Astrit Gjata, të dy me banim në qytetin bregdetar. Ata u arrestuan, pasi dyshohet se nuk kanë vepruar në momentin që makina që transportonte shumën prej 7.5 milionë lekësh të reja të Drejtorisë Rajonale të Transportit Rrugor në një bankë të nivelit të dytë, e cila ndodhej vetëm 500 m larg. "Specialistët për krimet në Komisaratin e Policisë Durrës kanë arrestuar në flagrancë shtetasit: F.S. 46 vjeç, punonjës në shoqëri sigurimi private dhe A.Gj. 55 vjeç, banues në Durrës, punonjës në shoqëri sigurimi private. Shtetasit e mësipërm janë arrestuar pasi dyshohet të kenë konsumuar veprën penale "Shpërdorimi i detyrës" ku ditën e djeshme, në lagjen nr.14 Shkozët dyshohet se 3 persona me një mjet, nën kërcënimin e armës dhe të maskuar i kanë dalë përpara një mjeti (shoqëri private sigurimi) që po transportonte lekët e Ndërmarrjes së Drejtorisë Rajonale të Transportit Durrës në një bankë të nivelit të dytë dhe i kanë marrë një shumë parash. Vijnë puna për kapjen e autorëve të dyshuar", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë së Durrësit. Ndërkaq, dy policët privatë kanë deklaruar se nuk kanë abuzuar me detyrën dhe se e kishin të pamundur të reagonin, pasi tre grabitësit i kishin vënë armët në kokë.

**DËSHMIA E POLICËVE PRIVATË**

"Jemi të pafajshëm për ngjarjen e ndodhur në Shkozët, pasi tre persona na



Vendi ku ndodhi ngjarja



Drejtoria e policisë, Durrës

sulmuar dhe na vunë armët në kokë. Nuk kishim mundësi të bënim asnjë veprim. Nuk kishim mundësi të ndërhyjmë, pasi çdo gjë ndodhi shumë shpejt e në mënyrë të befasishme", janë shprehur gjatë marrjes në pyetje policët e kompanisë private të sigurimit. Ndërkaq, ata kanë deklaruar se tre personat u zunë pritë në rrugë. "Të tre personat që na zunë pritë në rrugë ishin të armatosur dhe të maskuar. Ata mbanin kapuçna në kokë dhe nuk mundëm t'i njihnim". Nga ana tjetër, blutë e Durrësit bëjnë përgjegjës dy policët privatë për ngjarjen e ndodhur mbremjen e së premtes në Shkozët. Sipas policisë së Durrësit, ngjarja ka qenë e mirëorganizuar.

**GRABITJA**

Ngjarja ka ndodhur në zonën e Shkozetit, 100 m

para mbikalimit të Unazës së plazhit. Tre personat e maskuar kanë shfrytëzuar kohën e keqe me shi dhe në një moment kur nuk ka pasur qarkullim rrugor të dendur dhe i kanë zënë pritë makinën së blinduar së një

firmë private sigurimi që po transportonte paratë e Drejtorisë Rajonale të Transportit Durrës në një bankë të nivelit të dytë. Burime pranë grupit hetimor pohuan për "GSH" se autorët e krimin kanë qenë në dije të

transportit të parave si dhe shumë që po transportohej në një gjatësi rruge prej 500 m. Po të njëjtat burime sqaruan, se grabitësit fillimisht kanë neutralizuar policët privatë dhe nën kërcënimin e armëve i kanë urdhëruar të hapnin derën e blindit. Ata kanë marrë kasafortën dhe janë larguar me një automjet tip "Benz" me ngjyrë të zezë në drejtim të Shijakut. Maskat kanë përfutur dhe nga shiu i dendur dhe errësira, për t'i shpëtuar ndjekjes së policisë. Sipas hetuesve të çështjes, gjithçka ka ndodhur shumë shpejt dhe ka qenë e mirëorganizuar. Pas sinjalizimit për ngjarjen, policia ka ushtruar kontrollin të shumta në të gjithë zonën dhe përgjatë brigjeve të lumit Erzen deri në orët e vona të mbremjes.

**Makinat përplasen "kokë më kokë", plagosen 2 drejtuesit e mjeteve dhe 2 të tjerë**

**ELBASAN** - Katër persona janë plagosur si pasojë e një aksidenti rrugor të ndodhur pasditen e djeshme në aksin Elbasan-Tiranë. Mësohet se aksidenti ka ndodhur afër tunelit të Kërrabës në Bradashesh ku janë përfshirë dy automjete të cilat janë përplasur "kokë më kokë".

Sipas policisë, në afërsi të fshatit Shijon, mjeti me targa AA 657 UY, me drejtues shtetasin I.N., 16 vjeç, banues në Tiranë, është përplasur me mjetin me targa AA 492 UG, me drejtues shtetasin B.K., 29 vjeç, banues në Peqin. Si pasojë e aksidentit janë dëmtuar të dy drejtuesit e mjeteve; shtetasja V.K., 56

vjeçe, banuese në Peqin, e cila ishte pasagjere në mjetin me targë AA 492 UG, si dhe është dëmtuar shtetasia L.F., 17 vjeç, banues në Tiranë, i cili ishte pasagjer në mjetin me targa AA 657 UY. Të plagosurit janë transportuar në spitalin e Elbasanit, ku ndodhen jashtë rrezikut për jetën.



**Bënë për spital të riun, arrestohen dy agresorët**

**TEPELENË** - Dy persona janë arrestuar në Tepelenë, pasi kanë dhunuar një 22-vjeçar. "Nga Specialistët për Hetimin e Krimin në Komisaratin e Policisë Tepelenë u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve: A.A. 45 vjeç, banues në Tepelenë, dhe A.A. 41 vjeç, banues në Tepelenë. Arrestimi i këtyre shtetasve u bë pasi për motive të dobëta, kanë goditur me sende të forta shtetasin E.N. 22 vjeç, banues në Tepelenë, i cili ndodhet i shtruar në Spitalin Rajonal "Omer Nisani", Gjirokastrë, jashtë rrezikut për jetën", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Materialet ndaj dy shtetasve në fjalë i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë për veprime të mëtejshme



Gruaja e biznesmenit të vrarë në 2016, jam ndarë nga Hyqmet Nexhipi shumë vite më parë

**VLORE**

# "Pakoja e lidhur me celular shpërtheu sa mbyllëm dyert, 1 minutë na shpëtoi nga vdekja mua dhe burrin"

## Çifti i sapoardhur nga Greqia: Eksplozivi ishte vënë mes dy banesave, ne nuk kemi konflikte me askënd

Një ditë pas shpërthimit me tritol në një pallat në lagjen "Çole" të Vlorës ku si pasojë u dëmtuan dy apartamente, janë zbardhur detaje të reja në lidhje me këtë ngjarjeje. Mësohet se sasia e eksplozivit ishte vendosur pranë hyrjeve të dy banesave. Konkretisht afër apartamentit ku banon një çift, i cili sapo është kthyer nga Greqia si dhe banesës apartamentit ku banon Teuta Priti, ish-bashkëshortja e biznesmenit Hyqmet Nexhipit, i vrarë në janar të vitit 2016. Ndërkohë, që pas ngjarjes së ndodhur mbrëmjen e së premtës, burime zyrtare nga policia e Vlorës bënë me dije se lënda plasëse ishte vendosur pranë banesës së shtetasas T.P. Por ditën e djeshme "Gazeta Shqiptare" ka konstatuar se dëme më të mëdha materiale ka pësuar banesa e çiftit të ardhur nga Greqia, ku nga presioni i madh të gjitha dyert janë shkatërruar si dhe orënditë. Gjithashtu, dëme janë shkaktuar dhe në pallat, ku ka rënë të suvase. Në një intervistë për "GSH" çifti tregoi se janë kthyer nga Greqia vetëm 20 ditë më parë. Ata treguan me detaje gjithë ngjarjen, ndërsa u shprehën se nuk kanë konflikte me askënd dhe se nuk mund të kenë qenë ata objektivi i këtij shpërthimi të telekomanduar.

**DËSHMIA ÇIFTIT**

"Sapo kisha mbërritur në shtëpi, kur pashë një celular me një pako të lidhur. Në atë moment trokiti fqinja në derë dhe i tha tim shoqi shiko se është një telefon këtu në shesh dhe mos e ka harruar gjë gruaja jote ose mund të ju ketë rënë juve. Im shoq ia ktheu. Jo nuk di gjë çfarë është ky celular këtu. Pas një sekonde a minuti, sa mbyllëm dyert dhe u futëm në kuzhinë, ajo shpërtheu. Po të ishim një hap më afër do të ishim hedhur në erë komplet dhe unë dhe im shoq", tha gruaja e ardhur nga Greqia. Ndërkaq, ajo u shpreh se "ne jemi njerëz të patrazuar në kuptimin e mirë të fjalës. Shikojmë punën tonë. Duam qetësi. U cmonda, dhe nuk mund ta besojmë se ende mund të ndodhin gjëra të tilla". Pranë banesës së çiftit është apartamenti i marrë me qira nga ish-gruaja e biznesmenit të vrarë dy vjet më parë, Hyqmet Nexhipit. Ky i fundit u ekzekutua më 23 janar të vitit 2016, në makinën e tij tip "Honda" në rrugën "Transballkanike". Ndërsa, makina e autorëve u gjet në lagjen "Çole" e braktisur: 53-vjeçari ishte pronar i anijes së peshkimit "Drita" dhe rezu-



Banorja që u dëmtua shtëpia duke folur për "GSH"



Biznesmeni i vrarë në 2016-ën Hyqmet Nexhipi

lontë i dënuar para 6 vitesh në Itali për shfrytëzim prostitucioni.

**ISH-GRUAJA E BIZNESMENIT TË VRARË**

Policia e Vlorës deklaroi zyrtarisht se sasia e tritolit ishte vendosur para derës së apartamentit të marrë me qira nga shtetasja T.P., e veja e biznesmenit të vrarë. Ndërsa, ishte vendosur në mes të dy banesave dhe nuk është e qartë se kush ka qenë objektivi. Vetë Teuta Priti pohoi se ka vite që ishte divorcuar nga biznesmeni që u vra në rrugën "Transballkanike", Hyqmet Nexhipi dhe jetonte vetëm me vajzën dhe me djalin. Ajo sqaroi se në banesën e marrë jeton vetëm me vajzë, pasi djalin e arrestuan që në kohën kur u vra i ati, pasi iu gjet një sasi prej 90 gr lëndë narkotike dhe është akoma në burg. Do të jenë hetimet e mëtejshme që do të përcak-

tojnë se kush ka qenë objektivi i shpërthimit me eksploziv. Pas ngjarjes, policia e Vlorës nuk ka shoqëruar apo ndaluar asnjë person në lidhje me shpërthimin. Të vetmit që janë marrë në pyetje janë banorët e pallatit, të cilët ishin dëshmitarë në momentin kur ndodhi ngjarja.



Dëmet e shkaktuara nga eksplozivi

**SHPËRTHIMI**

"Pas një sekonde a minute, sa mbyllëm dyert dhe u futëm në kuzhinë, lënda plasëse shpërtheu. Po të ishim një hap më afër do të ishim hedhur në erë komplet dhe unë dhe im shoq", -tha gruaja e ardhur nga Greqia. Ndërkaq, ajo u shpreh se "ne jemi njerëz të patrazuar në kuptimin e mirë të fjalës. Shikojmë punën tonë. Duam qetësi. U gremda, dhe nuk mund ta besojmë se ende mund të ndodhin gjëra të tilla".

**POLICIA**

Policia e Vlorës deklaroi zyrtarisht mbrëmjen e së premtës se sasia e tritolit ishte vendosur para derës së apartamentit të marrë me qira nga shtetasja T.P., e veja e biznesmenit të vrarë. Ndërkaq, rezultoni se eksplozivi ishte vendosur në mes të dy banesave dhe nuk është e qartë se kush ka qenë objektivi. Vetë Teuta Priti pohoi se ka vite që ishte divorcuar nga biznesmeni që u vra në rrugën "Transballkanike", Hyqmet Nexhipi dhe jetonte vetëm me vajzën.



**I dënuar me 16 vite burg për vrasje, ekstradohet nga Greqia shqiptari**

**TIRANË** - Një shtetas shqiptar i dënuar me 16 vite burg për vrasje është ekstraduar nga Greqia. Mësohet se nga Specialistët e Interpol Tirana u krye ekstradimi nga Athina/Greqi drejt vendit tonë i shtetasit shqiptar, Bardhok Frroku, 43 vjeç, lindur në Pukë. Sipas burimeve zyrtare nga policia, Frroku ishte shpallur që kërkim ndërkombëtar që prej vitit 2003 për ekzekutimin e fqinjit të tij. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë e ka dënuar atë me 16 vjet burgim për veprat penale: "Vrasje me paramendim" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarakë dhe e municionit". Si rezultat i bashkëpunimit të Interpol Tirana me Interpol Athinën, u bë i mundur arrestimi dhe ekstradimi i tij nga Greqia drejt vendit tonë.



## I gjenden në çantë 4 mina me telekomandë dhe heroinë, arrestohet 52-vjeçari nga Elbasani

**LEZHË** - Katër mina me telekomandë si dhe rreth 130 gr lëndë narkotike e llojit heroinë sekuestruar gjatë operacionit të koduar operacionit "Trotyl" në Lezhë. Burime nga policia lokale bënë me dije se është arrestuar në flagrancë 52-vjeçari

Ali Novi, banues në Elbasan (i dënuar më parë). Mësohet se Novi u kap me çantën sportive, brenda së cilës kishte fshehur 4 mina për shpërthim të telekomanduar nëpërmjet celularit, si dhe sasinë e drogës. Ai akuzohet për veprat pe-

nale: "Trafikim i lëndëve plasëse" dhe "Prodhim e shitje e lëndëve narkotike". Materialet procedurale në ngarkim të tij iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës Shkallës Parë Lezhë për veprime të mëtejshme.

**SHPALLJE ANKANDI**

Zyra Përbarimorë "E.G Bailiff Service" me përbaruesit gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë **24.12.2018 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup>** në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i lli-htë për shitjen e pasurisë së paluajtshme, Arë me sipërfaqe totale **1500 m<sup>2</sup>** me numër pasurisë 6/90, volumn 9, faqe 174, zona kadastrale 1879, e ndodhur në Grykë Lumi, Lezhë në pronësi të Z.Gjon Zef Gjoka me vlerë fillestare në ankand **15.876** (Pesëmbëdhjetmijë e tetëqind e shtatëdhjet e gjashtë) EUR. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit **0672027580, +355 4 22 31 888**, email enuar.merko@gmail.com

**NJOFTIM**

Në datë **18.12.2018 në orën 16.00** në zyrën e përbaruesit gjyqësor privat Iriza Tereziu PF me adresë në "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njësia Tregtare nr.10, Tiranë", zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit "Truall+Ndertesë" me sip. Truall 300 m<sup>2</sup> dhe sip.ndertesë 120 m<sup>2</sup>, me nr.pasurie 522/10/1, volumn 6, faqe 2, zonë kadastrale 1167, ndodhur ne Bërxull, Tiranë.**Cmimi ne ankand te parë është në vlerën 3,940,248 (tre milion e nëntëqind e dyzet mijë e dyqind e dyzet e tetë) lekë.**

**NJOFTIM**

Në datë **19.12.2018 në orën 16.00** në zyrën e përbaruesit gjyqësor privat Iriza Tereziu PF me adresë në "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njësia Tregtare nr.10, Tiranë", zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit "Truall+Ndertesë" me sip. Truall 220 m<sup>2</sup> dhe sip.ndertesë 97 m<sup>2</sup>, me nr.pasurie 11/23, volumn 10, faqe 229, zona kadastrale 8503, ndodhur ne Lagjia "Jani Vruho", Berat.**Cmimi ne ankand te parë është në vlerën 3,280,000 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.**



**EVENTIMENTI**

## Aeronautistë nga gjithë bota në restorantin e "Birra Korça": Gjithçka me shumë stil

120 aeronautistë nga e gjithë bota kanë zgjedhur të darkojnë këtë fundjavë në restorantin e "Birra Korça". Një darkë me gatime tradicionale, shoqëruar me birra "Korça" të freskët ka qenë zgjedhja e pjesëmarrësve të Kampionatit Botëror të Aeronautikës, i cili po zhvillohet në Korçë. Teksa janë ndalur në restorantin e "Birra Korça", atje ku ndërthuren elementët fantastike të dekorit të festës me shijen magjike të birrës dhe gatimet tradicionale, aeronautistët janë mahnitur nga ajo çfarë kanë shijuar.

"Jetoj në Anglinë e Veriut dhe kjo është vizita ime e katërt në Shqipëri, por e para në Korçë. Më pëlqen shumë dhe po shijoj birrën "Korça" tha aeronautisti anglez Andy Webster.

"Është vërtet shumë bukur këtu po shikoj zbukurimet dhe është vërtet me stil" u shpreh Joanne Van den Berg, një tjetër aeronautist.



Aeronautistë nga e gjithë bota dje në restorantin e "Birra Korça"

Birra "Korça" ka ditur si ta bëjë mbrëmjen e tyre të veçantë duke i mahnitur me cilësinë e saj. Aeronautistja nga Koreja veçoi ushqimin tradicional shqiptar si të preferuarin e saj, ndërkohë që po e shoqëronte me birrë të zezë "Korça" ajo theksoi

se i pëlqen jashtë mase. "Jam nga Koreja, është hera ime e parë që vij në Shqipëri. Më pëlqen shumë Korça dhe ushqimi tradicional shqiptar është i preferuari im. Kam provuar birrën e zezë "Korça" dhe më pëlqen jashtë mase." -tha Eun-

**"BIRRA KORÇA"**  
Një darkë me gatime tradicionale, shoqëruar me birra "Korça" të freskët ka qenë zgjedhja e pjesëmarrësve të Kampionatit Botëror të Aeronautikës, i cili po zhvillohet në Korçë. Teksa janë ndalur në restorantin e "Birra Korça", atje ku ndërthuren elementët fantastike të dekorit të festës me shijen magjike të birrës dhe gatimet tradicionale, aeronautistët janë mahnitur nga ajo çfarë kanë shijuar.

young Cho.  
Birra "Korça" dhe gatimet e mjeshtrove janë shijuar nën tingujt e muzikës live që restoranti ofron. Aeronautistët shqiptarë dhe të huaj darkuan dhe festuan deri në orët e para të mëngjesit.

Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore shpjegon procedurën e dhënies së parave

# Pensionistët, të hënën ndahen shpërblimet

*Astrit Hado: Numri total i përfituesve është 650 mijë e 600 përfitues*

Duke filluar nga dita e hënë, të gjithë pensionistët mund të tërheqin shpërblimet prej 5 mijë lekësh të reja që qeveria vendosi të japë në prag të festave të fundvitit. Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Astrit Hado u shpreh për Agjencinë Telegrafike Shqiptare se shpërndarja e shpërblimeve do të bëhet sipas një kalendarit të përcaktuar dhe Posta do të punojë me orar të zgjatur. "Ditën e hënë në mëngjes nis procesi i shpërndarjes së shpërblimeve dhe të gjithë ata që kanë datën në këtë grafik, pavarësisht nga llojet e pensioneve, do ta marrin shpërblimin bashkë me pensionin. Dhe të gjithë ata, po themi ata që e kanë marrë pensionin ditën e hënë, 3 dhjetor do të lihet që të hënën pasdite të marrin shpërblimet, në varësi të grafikut të cilin do ta publikojmë", - tha Hado për ATSH. Ai argumentoi se në rastet kur pensionistët nuk do të duan ta tërheqin shpërblimin për arsye të ndryshme, nuk do të ketë asnjë penalitet, pasi mund ta tërheqin edhe në 2019. "Për ata që për arsye të ndryshme nuk e tërheqin shpërblimin, ose nuk paraqiten, shpërblimi do të vazhdojë t'i paguhet



Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Astrit Hado

**50**

**MIJË LEKË SHPËRBLIM**

Pensionistët në mbarë vendin do të marrin 50 mijë lekë të vjetra shpërblim për festat e fundvitit. Ky vendim është marrë ditën e djeshme nga Këshilli i Ministrave dhe është miratuar nga kryeministri i vendit Edi Rama.

edhe gjatë 2019-ës". Drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore sqaroi, gjithashtu, se të gjitha pikat e Postës do të punojnë më orar të zgjatur. "Duke filluar nga ora 8 e mëngjesit deri rreth mesditës, punonjësit e Postës do t'u shpërndajnë pensionin atyre që kanë ditën dhe pasdite do të shpërndajnë shpërblimin vetëm për ata persona që u ka kaluar data e marrjes së pensionit. Sigurisht, që do të

punojmë me orar të zgjatur. Numri total i përfituesve është 650 mijë e 600 përfitues", - përfundoi Hado.  
**KUSH E PËRFITON?**  
Përkatësisht 50 mijë lekëshin do e marrin të gjithë personat që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti, pension familjar dhe pension social. Të drejtën për të përfituar shpërblimin në masën e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, e kanë edhe ata persona që kanë

datë të fillimit të pensionit deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.  
"Shpërblimin e fundvitit e marrin edhe individët që marrin pension, sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972. "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të

**HADO**  
"Ditën e hënë në mëngjes nis procesi i shpërndarjes së shpërblimeve dhe të gjithë ata që kanë datën në këtë grafik, pavarësisht nga llojet e pensioneve, do ta marrin shpërblimin bashkë me pensionin.

ndryshuar.", -theksohet në vendimin e Këshillit të Ministrave. Edhe personat që marrin pension, sipas ligjit nr.150/2014, "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", personat që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr.8685, datë 22.6.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake", të ndryshuar kanë të drejtë të marrin shpërblimin e fundvitit. Ndërkohë këtë të

fundit mund ta tërheqin edhe personat që marrin pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas ligjit nr.10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtitimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Kategoria e fundit e individëve që mund të marrë shpërblimin prej 50 mijë lekësh të vjetra është ajo e personave që nuk përfitojnë pension, por që trajtohen vetëm me shpërblimin financiar si veteran të LANÇ-it, sipas vendimit nr.190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin e ligjit nr.7874, datë 17.11.1994, "Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar", si dhe personat, të cilët marrin vetëm pension të posaçëm për merita të veçanta, sipas dispozitave të ligjit nr.4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë".



Qeveria miraton vendimin për kompensimin financiar të atyre që u janë zënë tokat nga "informalët"

# Emrat e pronarëve, si ndahen 6 milionë euro

## ALUIZNI publikon listën e përfituesve në Tiranë, Elbasan, Vlorë, etj

Këshilli i Ministrave ka miratuar përdje vendimin për kompensimin financiar të pronarëve të pa surive të paluajtshme, pronë private, për sipërfaqet takuese, të zëna nga ndërtimet informale në drejtoritë e ALUIZNI-t: Tiranë Veri, Elbasan, Tiranë Jug, Tiranë Shtesat, Vlorë, Durrës, Tiranë Rurale, Sarandë,

Shkodër, Lezhë, Fshatra Turistikë dhe Kamzë Vorë. Dje, ALUIZNI bëri publik emrat e përfituesve.

Masa e kompensimit është 59 975,25 m<sup>2</sup> dhe vlera e përgjithshme e kompensimit financiar është 801 927 925,69 lekë. Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga

ndërtimet pa leje shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtitimit të Pronave, pas miratimit nga kreditori. Gjithashtu, për një sërë parcelash, shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtitimit të Pronave, pas zgjidhjes në rrugë gjyqësore të shkakut të kufizimit.

### AGJENCIA E LEGALIZIMIT DHE INTEGRIMIT TE ZONAVE/NDERTIMEVE INFORMALE LISTA EMERORE E SUBJEKTEVE QE PREKEN NGA NDERTIMET INFORMALE TE KUALIFIKUARA, MASA DHE VLERA E SHPERBLIMIT

Te dhënat e Pasurisë së Legalizuar										Kompensimi i Pronarëve						
Emër	Atesi	Mblëmëri	Numi i Pronarëve që kompensohen	Emër	Atesi	Mblëmëri	Masa e kompensimit (m <sup>2</sup> )	Çmimi (leke/m <sup>2</sup> )	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)	Emër	Atesi	Mblëmëri	Masa e kompensimit (m <sup>2</sup> )	Çmimi (leke/m <sup>2</sup> )	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)	
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17	9	10	11	12	15	16	17
TIRANE JUG																
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 2776																
BARJAM	ISMAIL	ALLKO CI	662	QERIM	SELMAN	SHEHU				663	GANI	HAKI	MANÇAKU			
			664	FIQIRI	HAKI	MANÇAKU				665	HAXHUE	EGRO				
			666	ASIM	SHAQIR	DERVISHI				667	SADETE	HAKI	TOPI			
			668	FATBARDHA		SHPENDI	354.00	878	310.812.00							
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 3866																
ANTON	HILE	PJETRI	669	DONILDA	VIKTOR	SULAJ	27.67	4.242	117.376.14							
MEJTE	MUHARREM	SHIMA														
MUHARRRE M	GANI	DERVISHI	670	SHYQYRI	ADEM	VRAPI	500.00	4.242	2.121.000.00							
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8100																
			671	ADA	SHABAN	REPISHTI										
			672	EMA	SHABAN	PREZA										
			673	ARTUR	SHABAN	DAJA										
			674	FLAMUR	XHEMAL	KALLCIU										
			675	FATBARDH	XHEMAL	KALLCIU										
			676	GEZM	XHEMAL	KALLCIU										
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 2380																
PERPARIM	XHEVDET	TAKAJ	686	SHPETIM	SHABAN	KARAJ	488.60	507	247.720.20							
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 3321																
			687	CEZAR		BESHIRI										
			689	PETRI		BESHIRI										
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8190																
BESNIK	HAMIT	KOLAVERI	707	LIZA		MATIARYAJRIM A	257.60	33.755	8.695.288.00							
XHELIL	SHEFKO	SHINI	708	LIZA		MATIARYAJRIM A	96.70	33.755	3.264.108.50							
			709	KRËSHNIK	SHABAN	LUSHAJ	61.70	33.755	1.745.133.50							
			710	NIMETE		CELA	43.80	33.755	1.478.469.00							
			711	GEZM		HYSA										
			712	LUAN		MUMAJESI										
			713	SOKOL		CELA										
			714	HATIXHE		MUMAJESI										
			715	SILVANA		KAIMI										
			716	JETMIRA		HOËHA										
			717	ASTRIT		KAIMI										
			718	FATMIR		MUMAJESI										
			719	AISHE		MUMAJESI										
BASHKIM	ASLLAN	GJONI	720	AGIM		MUMAJESI	180.50	33.755	6.052.777.50							

Ta dhënat e Pasurisë së Legalizuar			Kompensimi i Pronarëve						
Emër	Atësi	Mbiemër	Numeri i Pronarëve që kompensohen	Emër	Atësi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m <sup>2</sup> )	Çmimi (leke/m <sup>2</sup> )	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17
			721	REXHEP		KAJMI			

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 2105

GRIGORIS	KAMBER	PRIFTI	722	YLLSON	RIZA	AGOLLI	43.90	4.242	185.223.80
			723	DASHNOR	AJAZ	VISHA			
			724	SHKELQIM	QAMIL	KUPA			

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 3976

XHEVIT	AHMET	SALLAKU	725	NAILE		MUMAJESI	389.50	479	185.570.50
			726	BARDHYL		MUMAJESI			
			727	BAJRAM		MUMAJESI			
			728	MUBAREQ		MUMAJESI			
			729	ALBANA	SELFO	DEMI			
			730	BASHKIM	RESHIT	ARBANA			
			731	ISLAM	RESHIT	ARBANA			
			732	ARMANDO	SELFO	MOSHO			
			733	ELVUE	RESHIT	VOGLI			
			734	MAKSIM	MUHARREM	MUMAJESI			
			735	MIRIAM	MITHAT	MUMAJESI			
736	MILUKA	MITHAT	LATA						
737	EDMOND	MITHAT	MUMAJESI						

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 3321

ARBEN	HAMIT	MALKOLLARI	738	DASHAMIR		DERVISHI	251.00	2.560	668.160.00
SKENDER	LUL	HARIZI	739	DASHAMIR		DERVISHI	407.00	2.560	1,041.920.00
PETRIT	M EFAIL	DUKA	740	IBRAHIM	IDRIZ	CULLHAJ	163.20	2.560	417.792.00
ENGJELL	DYLEMAN	CELMETA	741	ARDJAN	ABDULLA	MUCA	309.90	2.560	793.344.00

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8180

ALI	RIZA	META	742	KRYEGJYSHATA BOTERORE BEKTASHIANE			368	31270	11,507,360.00				
MEDI	RIZA	METAJ		KRYEGJYSHATA BOTERORE BEKTASHIANE									
				743	KRYEGJYSHATA BOTERORE BEKTASHIANE					46.8	31270	1,463,436.00	
				744	ADRIAN	FEJZO				FEJZO	263	31270	8,224,010.00
				745	LILIANA	FEJZO				FEJZO			
			746	MAJLINDA	FEJZO	FEJZO							
ERLET	MYQEREM	MALE	747	SHPRESA	FEJZO	FEJZO							

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 3976

BESNIK	ABAZ	HIDRI	748	ISMAIL	KASEM	SPAJA	68.00	479	32,572.00
--------	------	-------	-----	--------	-------	-------	-------	-----	-----------

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8190

Ta dhënat e Pasurisë së Legalizuar			Kompensimi i Pronarëve						
Emër	Atësi	Mbiemër	Numeri i Pronarëve që kompensohen	Emër	Atësi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m <sup>2</sup> )	Çmimi (leke/m <sup>2</sup> )	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17
			749	HATEM	HOXHA	HOXHA	50.3	33755	1,697,876.50
			750	IBRAHIM		HOXHA	10.7	33755	361,178.50
			751	AIDA		FRASHERI(BESHQI)			
			752	ARDIAN		TOPTANI			
			753	BEHUE		ALDA(TOPTANI)			
			754	FADIL		TOPTANI			
			755	MELEQ		FRASHERI			
			756	MYNYRE		TOPTANI			
			757	NADIA		FRASHERI			
			758	NIRVANA		(FRASHERI)LEKAJ			
			759	XHEMILE		TOPTANI			

TIRANE SHITESAT

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8110

FESTIM	ALI	GJUZI	760	AGRON	GANI	DELIU	422.27	23703	10,009,065.81
			761	SKENDER	RUSTEM	DELIU			
			762	AIDA	GANI	DELIU			
			763	BEDRUE	XHEMAL	HALIDARI			
			764	BILAL	AZIS	DELIU			
			765	EDLIRA	GANI	MURATAJ			
			766	FATIME	RUSTEM	SHIMA			
			767	IKBALE	SEID	DELIU			
			768	ISLAM	RUSTEM	DELIU			
			769	NURUE	ABDULLA	DELIU			

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8210									
Emër	Atësi	Mbiemër	Numeri i Pronarëve që kompensohen	Emër	Atësi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m <sup>2</sup> )	Çmimi (leke/m <sup>2</sup> )	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17
FATLUM	HASANI	MUSHARRE	770	ALTIN	LULZIM	FORTUZI	27.72	38614	1,070,380.08
			771	ARBEN	XHEMAL	FORTUZI			
			772	AURORA		PAPA (MEZINI) XHEP			
			773	BEGIR	RAMAZAN	XHEPA			
AGIM	KADRI	BABOÇI	774	ERMAL	LULZIM	FORTUZI	27.72	38614	1,070,380.08
			775	EVA	MEHMET	SHKEMBI			
KOZETA	TOME	BABOÇI	776	FATOS	XHEMAL	FORTUZI	27.72	38614	1,070,380.08
			777	FLORA		LLUKMANI (MEZINI) XHEPA			
			778	GEZIM	SULEJMAN	XHEPA			
			779	HAJRIE	HAJREDIN	XHEPA			

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8270									
Emër	Atësi	Mbiemër	Numeri i Pronarëve që kompensohen	Emër	Atësi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m <sup>2</sup> )	Çmimi (leke/m <sup>2</sup> )	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17
ARTAN	SINAN	BASHO	780	ILIR	MEHMET	SHKEMBI	69.00	66969	4,620,861.00
			781	LEJLA	XHEMAL	FORTUZI			
			782	LIRUE		JOCA (XHEPA RAMAZAN) FORTUZI			
LINDITA	SINAN	VASILI	783	MAHMUDU		HAXHI	69.00	66969	4,620,861.00
			784	MAJUCLA		RECA (SHKEMBI) XHEPA			
			785	MARGARIT		ZOI			
			786	MRLINDA		ZAIMAJ (XHEPA SULEJMANI) TUFINA			
			787	MYZEJEN					
			788	NDRIM	XHAVIT	XHEPA			
HATEME	SHAQO	LULA	789	SOKOL	XHAVIT	XHEPA	69.00	66969	4,620,861.00

VLADIMIR	THEODHOR	TAÇE	790	ADIVUE	NEXHAT	HYDI	69.00	66969	4,620,861.00
QAZIM	HYSEN	ABDHOXHA	791	ASTRIT	NEXHAT	HYDI			
			792	BEXHET	NAMIK	HYDI			
ADRIATIK	FAIK	LAMÇE	793	ERMIRA	HASAN	HYDI			
			794	KUJTIM	NEXHAT	HYDI			
			795	LIRI	NAMIK	HYDI			
ERIKETA	JORGJI	LAMÇE	796	MENBUR	NEXHAT	HYDI			
			797	MIRIAM	NAMIK	HYDI			
FERDINAND	ISUF	HAXHIU	798	MYNYRE	ISAN	HYDI			
ARBEN	REFIT	RUSHITI	799	NEVIN	HASAN	HYDI			
			800	PEQER	ISAN	HYDI			
			801	REZGAR	HASAN	HYDI			

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8260									
Emër	Atësi	Mbiemër	Numeri i Pronarëve që kompensohen	Emër	Atësi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m <sup>2</sup> )	Çmimi (leke/m <sup>2</sup> )	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17
BILBIL	HYSNI	MURATAJ	802	AFERDITA	QAZIM	VORPSI	26.10	30783	803,436.30
			803	ALDA	KUJTIM	KIKA			
			804	ARJETA	MUHARREM	DALIPI			
			805	AVENIR	ALI	KIKA			
			806	BARDHYL	ALI	KIKA			
			807	FLUTURA	QAZIM	KIKA			
SAZAN	FEJZI	SULAJ	808	HALIL	QAZIM	KIKA			
EDUARD	ARAJIT	REXHEPAJ	809	KLEJDA	KUJTIM	KIKA			
			810	LIRI	QAZIM	KIKA			
			811	LULEZIM	QAZIM	KIKA			
PETRIT	XHEMAL	MALINDI	812	SADETE	SHABAN	KIKA			

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8260									
Emër	Atësi	Mbiemër	Numeri i Pronarëve që kompensohen	Emër	Atësi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m <sup>2</sup> )	Çmimi (leke/m <sup>2</sup> )	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17
ADRIAN	PETRIT	MALINDI	813	SOKOL	MUHARREM	KIKA	26.10	30783	803,436.30
			814	VERA		KIKA			
			815	VJOLLCA	QAZIM	VORPSI			

LUAN	SKENDER	BAKU	816	AFERDITA		VORPSI	17.50	30783	538,702.50
			817	ALDA		KIKA			
			818	ARJETA		PLESHI			
			819	AVENIR		KIKA			
			820	BARDHYL		KIKA			
			821	FLUTURA		KIKA			
			822	HALIL		KIKA			
			823	KLEJDA		KIKA			
			824	LIRI		KIKA			
			825	LULEZIM		KIKA			
			826	SADETE		KIKA			
			827	SOKOL		KIKA			
			828	VERA		KIKA			
			829	VJOLLCA		KIKA			



QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8210											
XHEMILE	ABDYL	GAZHE LI	830	AURORA	PAPA (MEZINI)						
			831	BEGIR	XHEPA						
			832	EREA	MILLONAJ						
			833	FLORA	LLUKMANI (MEZINI)						
RAJMOND A	GANI	AGALLIU (GAZHELI)	834	GEZM	XHEPA						
			835	HAJRUE	XHEPA						
			836	ILIR	SHKEMBI						
			837	LIRUE	XHEPA						
AGIM	GANI	GAZHE LI	838	LULZIM	FORTUZI						
			839	MANJOLA	RECI						
ADHURIM	GANI	GAZHE LI	840	MARGARIT A	XHEPA						
			841	MIRANDA	XHEPA						
			842	MYZEJEN	TUFNA						
			843	NDRIM	XHEPA						
KOSTANDI NA	KLIME	MATO	844	SOKOL	XHEPA						
			845	XHEMAL	FORTUZI						
			20.75	38614	801.240.50						

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8120												
AGRON	RAMADAN	MUHARR EMI	846	AHMET	IBRAHIM	VATHI						
			847	ALI	MUSA	KAIMI						
			848	BESIM	REFIK	KURTI						
			849	BILAL	MUSA	KAIMI						
			850	DESARA	IBRAHIM	VATHI						
			851	DIANA	REFIK	KURTI						
			852	FADIL	IBRAHIM	VATHI						
			853	FATIME	IBRAHIM	VATHI						
			854	LULJETA	IBRAHIM	VATHI						
			855	LUMTURI	IBRAHIM	VATHI						
			GENTIAN	HAJRI	RUSHITI	856	RASIM	MUSA	KAIMI			
						857	SAMI	MUSA	KAIMI			
						858	SHADAN	IBRAHIM	VATHI			
PETRIT	QEMAL	KASAPI	859	SHQIPONJ A	IBRAHIM	VATHI						
			860	VJOLLCA	IBRAHIM	VATHI						
			2.22	29106	64.615.32							

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8210										
SEIT	ZEQO	MICI								
VIKTORUE	ISLAM	ÇALLIKU								
FIQRUE	RIZA	SKENDO								
ANILA	AGRON	SKENDO	861	BRIGITA	XHEPA					
SILVANA	AGRON	SKENDO								
FIDARUE	FASLLI	TABAKU								
GANI	JONUZ	HOXHA								
			862	KURT	QAZIM	XHEPA	10.54	38614	406.991.56	

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8170										
ALFRED	MITHAT	MILLA	863	ABDYL	ISUF	XIBRI	10.00	32878	328.780.00	
			864	FIQIRI	ISUF	XIBRI				
			865	HAJRUE	ISUF	VIKA				

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8170									
Te dhënat e Pasurisë së Legalizuar			Kompensimi i Pronarëve						
Emër	Atësi	Mbiemër	Numri i Pronarëve që kompensohen	Emër	Atësi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m <sup>2</sup> )	Çmimi (leke/m <sup>2</sup> )	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17
			866	HAMDI	ISUF	XIBRI			
			867	HAMIDE	ISUF	LLUKA			
			868	RIZA	ISUF	XIBRI			
			869	SOFIE		XIBRI			

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8110									
FATMIR	SEFEDIN	KURTI	870	KASTRIOT	DJURMISH	LLANAJ	51.70	23703	1.225.445.10

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8270										
PELLUM B	NURI	ZAIMI								
KODHEL	TAIP	ISMAILAJ								
HALIM	MESUT	KOŠOVA	871	BORA	REXHEP	META				
VILSON	MUHAMET	SINAJ								
HIDAJ	ESTREF	PULA								
SPIRO	SOTIR	STERJEO	872	FITIM	REXHEP	META				
MERITA	HALIT	GJIRITI								

ROLAND	KLEANTH	VASO	873	RIDVAN	EQEREM	HADO			
LUAN	BEJKO	MATOHITI							
FELIKS	MASAR	BAÇI	874	RUMI	EQEREM	HADO	68.83	66969	4.609.476.27

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8250									
ILIR	XHELAL	CUFE							
HATUË	MAHMUT	HODO							
DED	MARK	VLADI	875	ZYMBYLE		HODO	60.00	30.783	1.845.980.00

QARKU VLORE, ZVRPP VLORE, ZONA KADASTRALE 8601									
			876	MYNYR		VRANARI			
			877	HATUË		MAHMUTI			

Te dhënat e Pasurisë së Legalizuar									
Emër	Atësi	Mbiemër	Numri i Pronarëve që kompensohen	Emër	Atësi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m <sup>2</sup> )	Çmimi (leke/m <sup>2</sup> )	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17
			878	VILHEM		VRANARI			
			879	PERIDE		VELIAJ			
			880	SANJUE		HAMZAJ			
			881	ZNIETE		MEZINI			
			882	ALI		VRANARI			
			883	LEONORA		VRANARI			
			884	SYRJA		VRANARI			
			885	MAHMUD		VRANARI			
			886	MARGARIT A		LUTAJ (BIMO)	428.00	10.903	4.666.484.00
ISLAM	FEÇE	TAHIRI	887	MYNYR		VRANARI	5	10903	54.515.00

QARKU VLORE, ZVRPP VLORE, ZONA KADASTRALE 8602									
BEXHET	BELUL	NUREDINI	888	MBIVENDOSJE			31.69	10.903	345.516.07
			889	MBIVENDOSJE			207.00	10.903	2.256.921.00

QARKU VLORE, ZVRPP VLORE, ZONA KADASTRALE 8601									
MUHAMRE M	REFAT	GRAMAJ	890	GAZMEND		ZOGA	245.00	10.903	2.671.235.00
FATMIR	MUHAMRE M	GRAMAJ	891	EDLIRA		ZOGA	129	10903	1.406.487.00
			892	BUJAR		ZOGA			

QARKU VLORE, ZVRPP VLORE, ZONA KADASTRALE 8601									
DILAVER	FETI	HITAJ	893	SOKOL		AGALLIU	348.30	10.903.00	3.710.290.90
HEKTOR	FETI	HITAJ	894	SOKOL		AGALLIU	1.35	10.903.00	14.719.05
LIAN	RIZA	ARAPAJ	895	SAMI		KULAJ			
FATMIR	RIZA	ARAPAJ	896	HAMDI		KULAJ			
			897	JAHO		KULAJ			
			898	KADRIE		KULAJ			
			899	DASHMIRE		KULAJ			
			900	LIRETA		KULAJ			
			901	ENGJELLU SHET		KULAJ			
			902	VIKTOR		KULAJ			
							886.64	10.903	9.667.035.92

Te dhënat e Pasurisë së Legalizuar									
Emër	Atësi	Mbiemër	Numri i Pronarëve që kompensohen	Emër	Atësi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m <sup>2</sup> )	Çmimi (leke/m <sup>2</sup> )	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17
			903	EDLIRA		KULAJ			
			904	DRITAN		KULAJ			

QARKU VLORE, ZVRPP VLORE , ZONA KADASTRALE 8602									
			905	AFERDITA		LAMAJ			
			906	ARBEN		LAMAJ			
			907	LYZE		LAMAJ			
			908	DYLBËRE		LAMAJ			
			909	ELRIKA		LAMAJ			
			910	MBARIME		LAMAJ			
			911	MERUSHE		LAMAJ			
			912	MIRUSHE		LAMAJ			
			913	QAMILE		LAMAJ			
			914	SABINE		LAMAJ			
			915	SELMAN		LAMAJ			
			916	ZNIETE		LAMAJ			
PAVLI	JORGJI	PRIFTI	917	ZYRA		LAMAJ	414.11	10.903	4.515.041.33

(vijen)

## OPERA

## VASO TOLE:

## Rikthimi i gjinisë së vdekur, çfarë më frymëzoi për operën për Skënderbeun

Fatmira Nikolli

Fatos Qerimaj dhe Vaso Tole i kanë shtuar repertorit të muzikës shqiptare kontemporane një balet dhe një opera. Të dy kompozitorët janë vlerësuar në "Konkursin kombëtar për krijimtarinë muzikore". Çmim inkurajues iu dha kompozitorit të ri Jetmir Zaganjori prej jurisë së përbërë nga Thoma Simaku, Nicole LeFanu dhe Pedro Amaral.

Ka qenë Ministria e Kulturës që e ka organizuar dhënien e çmimeve të "Konkursit mbarëkombëtar të krijimtarisë muzikore" në zhanret e mëdha të muzikës skenike: opera, balet dhe muzikal. Konkursi u çel në kuadër të vitit 2018, shpallur nga qeveria shqiptare "Viti mbarëkombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeut", në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor. Veprat dhe kompozitorët konkurrues u ngjiten në skenë në natën e ndarjes së çmimeve në 'Ar' Turbina' në datën 14 dhjetor.

Tole mori pjesë në konkurs në zhanrin e muzikës skenike me Opera Solemne "Skënderbeu Kryezoti i Arbërit" me libret të Theofan Stilian Nolit.

I pyetur dhe nga "GSH" ai tha se "ky konkurs mbarëkombëtar i gjinisë muzikore skenike është përpjekja më serioze e institucioneve të kulturës dhe e kompozitorëve shqiptarë për të rigjallëruar operën dhe baletin shqiptar, të cilat prej 30 vitesh mund të konsiderohen gjini të vdekur. Që pas viteve 1990 ky është rasti i parë ku shohim një interes publik e shtetëror për gjinitë e mëdha muzikore skenike".

Vaso Tole shtoi se e nxiti një fakt i thjeshtë. "Në vitin e 550-vjetorit të vdekjes, konstatoj se ne nuk kemi në traditën tonë muzikore një veprë muzikore, e cila të nderojë kujtimin e SKËNDERBEUT, HEROIT TONË KOMBËTAR, ashtu siç është në traditën e madhe evropiane ky personaliteti të tilla nderohen me vepra muzikore të mëdha të dedikuara enkas, që në titull për të". Kompozitorit vërejtje për këtë ideoi strukturën e OPERAS SOLEMNE "Skënderbeu Kryezoti i Arbërit".

Ajo si strukturë, sqaroi kompozitorin, është bashkimi i OPERAS DRAMATIKE ku personazhi kryesor (në këtë rast vetë personazhi i SKËNDERBEUT) vetërrëfen, këndon jetën e tij përmes ARIEVE të mëdha të mbështetura në tekstin letrar të veprës të Fan S. Nolit. Ndër ariet përmend aria 'Ëndërr e Shën Gjergjit', 'Malli për atdhe', 'O



## Kompozitori shpallet fitues i konkursit të Ministrisë së Kulturës

burrani mbi ta', 'Lirinë s'ua solla unë' etj. "Nga ana tjetër PËRJETËSIA e HEROIT, e cila mbështetet në pjesët e MESHËS SOLEMNE të kompozuar prej meje e të kënduara nga kori në gjuhën latine. Pjesët e meshës janë Kyrie Eleison, Sanctus, Gloria etj. Pra, kemi njëkohësisht një veprë që tregon

jetën dhe përjetësinë e Heroit tonë", tha Tole. **KOMPOZITORI** Tole diplomohet për kompozicion në Fakultetin e Muzikës, pranë Akademisë së Arteve, në Tiranë,

më 1987, në klasën e prof. Kozma Larës. Mban titullin profesor dhe akademik pas një sërë studimesh dhe doktoraturash në fushën e etnomuzikologjisë: studime pa-

suuniversitare në kompozicion

pranë "Folkwang Hochschule", Essen-Gjermani, në klasën e prof. Wolfgang Hufschmidt si dhe studime pas doktoratës në Departamentin e Muzikologjisë pranë Universitetit të Athinës, Greqi. Karriera e tij kap një gamë të gjerë të një veprimtarie studimore dhe publicistike, me pjesëmarrje në shumë festivale, konferenca dhe trezëra për muzikën në Shqipëri dhe jashtë saj. Përfaqësues aktiv i brezit të ri të kompozitorëve shqiptarë, Vasil S. Tole është nismëtar i alternativave të reja krijuese dhe si një ndër mbartësit më të vendosur të konceptit të ristrukturimit të lëndës muzikore folklorike shqiptare, në dobi të gjetjes së identitetit dhe risive në muzikën bashkëkohore. Fitues i disa çmimeve të rëndësishme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, fitues i çmimit të parë të kompozimit "Dimitris Mitropoulos", Athinë 2001, me operën "Eumenides". Pas viteve '90 bëhet nismëtar i themeimit dhe drejtimit të disa organizmave të rëndësishme muzikore, si: ODEA, Akademi e Artit dhe Trashëgimisë, Karriera e tij shënon postin e drejtorit të Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit në Tiranë, si dhe ka mbajtur pozicionin e drejtorit të Trashëgimisë Kulturore në Ministrinë e Kulturës. Në vitin 2005, si ekspert i etnomuzikologjisë përgatiti dosjen e polifonisë me iso të Shqipërisë së Jugut, e cila u shpall nga UNESCO si "Kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit".

## 100 VJET NGA LETRA E STUDENTËVE SHQIPTARË PËR PRESIDENTIN WOODROW WILSON

15 dhjetori i këtij viti shënoi 100 vjet nga letra e studentëve shqiptarë të Vjenës drejtuar Presidentit të SHBA Woodrow Wilson, para Konferencës së Paqes.



Në 18 janar të vitit 1919 u mbajt Konferenca e Paqes e Parisit, takimi i fuqive aleate fituese të Luftës së Parë Botërore, me qëllim përcaktimin e kushteve të paqes ndaj fuqive humbëse të luftës. Për Shqipërinë kjo konferencë ishte e rëndësishme, pasi aty u caktua përfundimisht njohja e Shqipërisë si shtet i pavarur, u miratua integriteti i kufijve, duke ndaluar pretendimet territoriale të shteteve fqinje. Përpara konferencës, shumë grupe patriotësh shqiptarë, në kontinentin e vjetër dhe të ri, u përpoqën të ndërhy-

nin tek Presidenti i SHBA Woodrow Wilson, për të fituar simpatinë dhe mbrojtjen e tij në dobi të Shqipërisë. Mes letrave të shumta drejtuar Presidentit Wilson është edhe ajo e studentëve shqiptarë të Vjenës, të cilët e nënshkruan atë letër më 15 dhjetor 1918, plot 100 vjet më parë. Në mbyllje të letrës, studentët parashtrajnë: "Zotëri President! Në qoftë se në vendimin e paqes një komb lirinë i pa njojtun edhe do të përdoret kaq pa-drejtesisht, a mundet kurrë natë anë të botës të sigurohet paqë? Shqipëria, sikundër Konferenca e Londnit e kufizoj, kurrë s'mundet të rronte, kishite farën e vdekjes në gjakun e saj që në lindien e vetë. Me këtë mënyrë, Zotëri, deri tash bota na ka përdorur mizorisht, prandaj ngremë zërin tonë tek Ju, si mbrojtësi i njerëzimit, duke e



ditur sigur se marria pjesë e Shteteve të Bashkuara nën udhëheqjen të drejtë e të ndershme të Zotërisë s'Uaj në Kongresin e Paqës, drejtësia do të përmbushet dhe shqiptarët duke pasur të drejtën e vetvotimit për formën e qeverimit të tyre do të kenë lejen, si një komb i lirë, të hyjnë në Lindien e Kombëve. [...] Në emër të studentëve shqiptarë në Vient, të përvojuntunit, Jan Basho, Remzi Bape, H. Hifzi, Nush Bushati, Djavat Korça, Luigj Kakariqi, Gjovalin Gjiajri, Raku Buda, Fuad Aslan. Wien, Austri, 15/12/1918."





NGA ARMAND PLAKA

**S**jellja e eshtrave të Mit'had Frashërit pak kohë më parë, risolli edhe një herë në vëmendje çështjen e kolaboracionizmit gjatë Luftës së Dytë, të vlerave dhe antivlerave, të balistëve e partizanëve, çka e fokusoi për pak kohë vëmendjen nga temat e ditës në realitetin ku jetojmë.

Në mënyrë më të tërthortë, doli në sipërfaqe edhe çështja e kriminelëve të luftës dhe e gjykimit të tyre. Si rezultat u sollën këto ditë edhe lista të njohura e të panjohura me emra që ishin gjykuar nga "drejtësia popullore" si kriminelë lufte, e u ishin dërguar aleatëve të bashkëngjitura kërkesave për t'i sjellë për gjykim në vendin e origjinës, qysh në ditët e para të Pasluftës.

Në fakt, edhe Shqipëria ishte tashmë pjesë e një procesi e fenomenit që do të zinte faqet e para të gazetave të kohës, pas një lufte shkatërrimtare me shumë pasoja e

# Sa kriminelë lufte pati Shqipëria sipas procesit të Nyrembergut?

*Çfarë na dëshmon një gazetë ish-gjermanolindore në vitin 1945, vetëm një muaj para nisjes së operacionit më të famshëm të drejtësisë ndërkombëtare*

viktima të pafajshme, ku terrori dhe tmerrret e krimeve të luftës, ishin pjesë e pandashme e kohës që sapo ishte lënë pas.

Kësisoj, më shumë se një vit më parë, ish-drejtuesi i arkivës në Ministrinë e Brendshme, Kastriot Dervishi publikoi një listë prej 118 emrash, të cilët ishin shpallur si kriminelë nga regjimi komunist i kohës. Lista në fjalë u ringjall në vitin 1991, pas formulimit të saj

në vitin 59', kohë në të cilën regjimi i kohës kishte shenjuar emrat e "armiqve të popullit" që ishin larguar gjatë kohës së luftës. Me dekretin nr.3005, datë 23.11.1959 të Presidiumit të Kuvendit Popullor, regjimi komunist pat shpallur një amnisti për të arratisurit politike, prej së cilës u amnistuan 7.003 persona dhe u cilësuan "kriminelë lufte" 208 të tjerë.

Proces unanimit i fituesve

Por përtej kërkesave të dërguara nga Tirana zyrtare në shtab aleat në Itali, Londër e Uashington, 15 vjet para dekreteve të sipërpërmendura, në kryeqytetin britanik akoma diskutoheshin se çfarë duhej të bënin me kriminelët e luftës dhe nëse ata duhej të procedoheshin në mënyrë individuale apo jo?

E gjitha kjo ndodhte vetëm një muaj para se të vendosej unani-

misht nga ish-BRSS, SHBA, Britania e Madhe dhe Franca, nisja e një operacioni gjyqësor ndërkombëtar e të unifikuar, të cilin bota s'e kish parë kurrë më parë. Krugëtimi i tij nisi në nëntor 1945 e u përmbyll në tetor 1946, sikurse dihet tashmë, me marrjen e shumë vendimeve e kryerjen e shumë ekzekutimeve.

→ Vizion në faqen 14

**Në këtë numër: XHEVAHIR SPAHIU, JOHN BRADLEY PËR LULJETA LLESHANAKUN, FARUK MYRTAJ, ARBEN MEKSI, ARMAND PLAKA, LULJETA DANO ETJ...**

A

ARGUMENT

NGA ARMAND PLAKA

Vijon nga faqja 13

Iniciativat aleate për ndëshkimin e kriminelëve të Luftës kishin nisur qysh në prill 1942 me hartimin e një rezolute përkatëse nënshkruar nga përfaqësuesit e nëntë shteteve të pushtuara ndërkaq nga Gjermania naziste. Por baza legale reale për nisjen e procesit të Njrembergut ishte vendosur nëpërmjet hartimit e nënshkrimit të së ashtuquajturës "Karta e Londrës" më 8 gusht 1945 nga ana e katër fuqive fituese të Luftës, e cila e reduktoi konceptin paraprak deri "ndëshkimin e kriminelëve kryesorë të luftës të vendeve të Boshtit nazist".

Si pasojë në fund të procesit u gjykuan rreth 200 kriminelë të dyshuar të luftës me nacionalitet gjerman dhe 1.600 të tjerë u lanë për gjykim nga kanalet e tjera të drejtësisë, përkatësisht gjykatat ushtarake. Ekzekutimet sidoqoftë ishin më të vogla në numër dhe përfshinë ekskluzivisht gjermanët, ndërsa bashkëpunëtorët e tyre u lanë të ndëshkoheshin nga sistemet nacionale të drejtësisë në vendet e tjera europiane, nga Norvegjia në ish-Jugosllavi, Shqipëri e Greqi.

Sidoqoftë, shumë e rëndësishme është të dihet fundja se cila ishte lista paraprake që kishin në dorë tashmë vetë aleatët me ata që mund të quheshin "peshqit e mëdhenj", të cilët s'duhej t'i shpëtonin drejtësisë ndërkombëtare e të gjykoreshin kësajsoj me konsensus të të gjitha palëve si kriminelë lufte pavarësisht nacionalitetit? Akoma më e rëndësishme bëhet për ne si shqiptarë të mësojmë nëse në këtë listë ekzistonin shqiptarë dhe sa ishte numri i tyre, e mundësisht pse jo, edhe emrat e tyre.

#### DËSHMIA NGA SHTYPI GJERMAN I KOHËS

Fare rastësisht, duke shfletuar një arkivë të pasur gazetash nga koha e ish-RDGJ-së, vura re një syresh të vitit 1945, pra akoma pa u zhvilluar Gjyqi i famshëm i Njrembergut, një raport me titull: "Parime themelore të procesit kundër kriminelëve të Luftës", botuar në "Neue Zeit" më 18.10.1945, fq. 2, ku më konkretisht në një pasazh shkruhej: "Vetëm pak kohë pas botimit të përmblidhjes së të ashtuquajturit "Libri i Bardhë" nga ana e britanikëve, u vendos në Londër ngritja e një Komisioni të Aleatëve "Për Hetimin e Krimeve të Luftës". U shpall osën natyrisht mendime në formë teorike dhe konstatime, të cilat mund të konsideroheshin të mundura në çdo kohë. Por këto përgatitje shtruan rrugën që vetëm pak kohë pas përfundimit të Luftës, në ditët e para të qershorit të këtij viti, komisioni të mund të bënte të ditura një sërë konstatimesh. Shifrat që lidhen me ata persona, të cilët mund të konsiderohen tashmë si "Kriminelë Luftë", janë këto: 2524 gjermanë në pozicione drejtuese, 561 gjermanë për shkak të pjesëmarrjes në operacione terrori. Përveç tyre, 110 italianë, 2 shqiptarë, 17 bullgarë, 2 hungarezë, 2 rumunë. Në këtë fazë bisedimet paraprake shërbyen që një propozim amerikan të dilte në pah vetvetiu: Ai që kriminelët e luftës të gjykoreshin sëbashku dhe jo me procese individuale nga një Gjykatë Ndërkombëtare".

#### PËR ALEATËT, SHQIPTARËT KRIMINELË LUFTË ISHIN VETËM DY

Ja çfarë na dëshmon një gazetë ish-gjermanolindore në vitin 1945, vetëm një muaj para nisjes së operacionit më të famshëm të drejtësisë ndërkombëtare, që i vuri para dënimit kriminelët e botës. "Neue Zeit", një gazetë e sapo dalë në qarkullim me lejen e sovjetikëve në atë që quhej "Zona sovjetike e pushtimit" në Berlinin Lindor, pikërisht në muajt e parë të Pasluftës, pohon se nga pala shqiptare në këtë "listë të zezë", nuk rezultojn më shumë se dy emra, edhe pse emrat e tyre nuk bëhen të ditur e mund të përbëjnë kësajsoj jo vetëm për mua, një shkak për të gërmuar më thellë në këtë çështje...

# Sa kriminelë lufte prodhoi Shqipëria sipas procesit të Nyrembergut?

Çfarë na dëshmon një gazetë ish-gjermanolindore në vitin 1945, vetëm një muaj para nisjes së operacionit më të famshëm të drejtësisë ndërkombëtare



Foto ilustruese nga seancat e Gjyqit të Nyrembergut, 1946.

Wenige Monate nach jenem zusammenfassenden britischen Weißbuch wurde in London die Errichtung einer Kommission der Alliierten „zur Untersuchung der Kriegsverbrechen“ beschlossen. Es waren naturgemäß theoretische Überlegungen und Feststellungen, die in jenem Zeitpunkt allein möglich erschienen. Aber diese Vorbereitungen boten die Grundlage dafür, daß wenige Wochen nach Kriegsende, in den ersten Juni-Tagen die Kommission bestimmte Festanträge konnte. Zahlen über die als Kriegsverbrecher benannten Deutschen im Schlüsseldes Deutschen wegen systematischen eben 110 Italiener, 2 Albanier, 1 Ungarn, 2 Rumänen. In jenem die Vorverhandlungen soweit

Faksimile e paragrafit ku flitet për 2 shqiptarë të akuzuar si kriminelë lufte në mbledhjen paraprake të komisionit përkatës në Londër në tetor 1945 për themelimin e Gjyqit të Nyrembergut, marrë nga artikulli me titull: "Parime themelore të procesit kundër kriminelëve të Luftës", botuar në "Neue Zeit" më 18.10.1945, fq. 2.

i së drejtës ndërkombëtare dhe fakteve e provave juridike të mbledhura e pranuar paraprakisht, si bazë për nisjen e një procesi gjyqësor, s'ishin pra veçse dy emra.

#### VLERËSIM PARAPRAK I KOMISIONIT "PËR KRIMET E LUFTËS"

Sigurisht se bëhej fjalë për një fazë paraprake përgatitore, që do ta çonte botën (siç del edhe nga ky raport) drejt një procesi historik e të unifikuar të palëve fituese në luftë, të ndëshkimit të kriminelëve e përgjegjësve të luftës. Edhe pse për shumikënd drejtësia s'u vu kur në vend dhe selektiviteti e interesat momentale bënë që shpesh kriminelët të faktuar, t'i rrëshqisnin drejtësisë, apo se nuk pati të gjykuar nga pala fituese. "Procesi i Nyrembergut" ia doli që gjithsesi të ngadhënjente e të shërbente si një ngushëllim për viktimat e shumta e tmerret që lufta la pas e pasojat e tij juridike u shtrinë edhe më tej në kohë e hapësirë duke ndëshkuar kriminelë lufte edhe shumë dekada më vonë, kudo dhe kurdo që ata kapeshin.

#### GJYQET "POPULLORE" NË LINDJE

Në territoret nacionale pas Luftë u vunë re sigurisht edhe plot ekzekutime e gjykime ekstreme, të mbaruara me histeri e shpesh padrejtësi, të cilat në raste të veçanta sipas shumë ekspertëve, duhet t'i nënshtrohen rigjykit. Proceset nacionale – si domos në lindje të kontinentit - ishin të bazuara në urretje e triumfin e palës që po vinte në pushtet, e nisur nga kjo. "Procesi i Nyrembergut" vijon të mbetet një proces mod-

#### Pretendimi i Tiranës për të larguarit e luftës

Rezultoni thjesht një fiasco edhe në aspektin e trajtimit juridik, pretendimi i Tiranës zyrtare të kohës për të gjykuar e si pasojë ekzekutoar një listë shumë të fryrë "bashkëpunëtorësh të fashizmit" e "kriminelësh lufte" nga Shqipëria, vendimi për të cilët tashmë ishte marrë me kohë dhe e bën edhe më të justifikuar frikën e vendimin e shumë eksponentëve të kohës për t'u larguar nga Shqipëria, duke parandjerë atë që i priste, edhe pse kjo me shumë kosto për vendin, një ndër të cilat ishte dhe mosangazhimi si dhe sa duhet, duke munguar fizikisht për të mundësuar kësajsoj një opozitë mëse jetike për fatet e vendit për periudhën në vijim.

"Neue Zeit", një gazetë e sapo dalë në qarkullim me lejen e sovjetikëve në atë që quhej "Zona sovjetike e pushtimit" në Berlinin Lindor, pikërisht në muajt e parë të Pasluftës, pohon se nga pala shqiptare në këtë "listë të zezë", nuk rezultojn më shumë se dy emra, edhe pse emrat e tyre nuk bëhen të ditur e mund të përbëjnë kësajsoj jo vetëm për mua, një shkak për të gërmuar më thellë në këtë çështje.

Tashmë një gjë është më se e qartë: Në mendjen e aleatëve, numri i atyre që mund të konsideroheshin "kriminelë lufte" me kombësi e nënshtrësi shqiptare, nisur nga gjykyimi



Përit e Komitetit Shqiptarë e Lirë, Frashëri, Kryeziu, Topkasi, Pall, Logroci, Kuta, Andoni. Në seksionin shqiptar të BBC në Londër, 1949





Faksimile e gazetës ish-gjermanolindore "Neue Zeit", 18.10.1945, fq. 2

el i drejtësisë përballë padrejtësisë, përballë krimeve e kriminelëve, një shembull i bashkëpunimit juridik e shumëplanësh mes palëve fituese të luftës, por edhe i trajtimit të drejtë të humbësve, i dënimit të përgjegjësve realë dhe jo popullit gjerman, çka e bën atë proces edhe sot e kësaj dite të besueshëm e të shumëstudiuar.

Nisur nga kjo, rezultojnë thjesht një fiasco edhe në aspektin e trajtimit juridik, pretendimi i Tiranës zyrtare të kohës për të gjykurur e si pasojë ekzekutuar një listë shumë të fryrë "bashkëpunëtorësh të fashizmit" e "kriminelësh luftime" nga Shqipëria, vendimi për të cilët tashmë ishte marrë me kohë dhe e bën edhe më të justifikuar frikën e vendimit e shumë eksponentëve të kohës për t'u larguar nga Shqipëria, duke parandjerë atë që i priste, edhe pse kjo me shumë kosto për vendin, një ndër të cilat ishte dhe mosangazhimi si dhe sa duhet, duke munguar fizikisht për të mundësuar kësajsoj një opozitë mëse jetike për fatet e vendit për periudhën në vijim.

**FRIKA E ALEATËVE, E JUSTIFIKUAR**

Nga ana tjetër, me këtë justifikohet edhe këmbëngulja e aleatëve për të mos dorëzuar tek Tirana zyrtare asnjë eksponent "kolaboracionist", i cili do mund të cilësohej si "kriminel luftime" nga regjimi komunist i sapoardhur në pushtet i Tiranës.

Sigurisht se numri dy, mund të mos përkohet vërtetë me realitetin, pasi njerëz me zell shtazarak për të kryer krime e terror për llogari të këmishave të zeza e kryqit nazist, mund të ketë pasur shumë më tepër, por Tirana zyrtare në listat që dërgonte duket qartazi se ishte shumë larg realitetit dhe çdo vendim e kishte të motivuar politikisht, duke i vënë damkën e "kriminelit të luftës" kujtëdo që ajo e llogariste si pengesë për planet e saj të afërta e të largëta për çimentimin e pushtetit të saj despotik.

**"LUFTA E FTOHTË" DHE REHABILITIMI I HESHTUR I ISH-NAZISTËVE**

Sigurisht se ngritja shumë e shpejtë mbi Europë e asaj që do njihet si "Perdja e Hekurt" dhe ravijëzimi i plotë i kontureve të një Luftë të Ftohtë, do të bënte që shumë eksponentë nazistë, bashkëpunëtorë të tyre dhe madje edhe kriminelë luftime, të viheshin në shërbim të CIA-s, KGB-së, STASI-t etj, sikurse edhe të bënin karrierë në hierarkinë komuniste të Tiranës e atë të Sigurimit, ish-këmbëzënjëz, për të cilët deri para pak viteve s'kemi ditur gjë se kishin qenë të tillë.

Washingtoni e Londra tashmë do të stepeshin gjithnjë e më shumë përballë kërkesave të Tiranës e do t'i hidhnin ato në kosh, në një kohë që madje me kalimin e viteve lista sa vinte e shtoej, duke mos parapëlqyer t'i trajtojnë me seriozitet ato, përsa kohë që regjimi i Hoxhës do të zhytej tashmë gjithnjë e më shumë në zullume që do t'a largonin atë gjithnjë e më fort nga Perëndimi.

**A**  
**ARGUMENT**

# A ka nevojë për një histori të re letërsia shqipe apo thjesht ta zëvendësojë ajo historinë?!

NGA BEN ANDONI

Letërsia është si një organizëm i gjallë, e cila kërkon gjithnjë idenë fikfikim duke u ushqyer. Nga ana tjetër, përpjekja që kanë bërë shumë autorë të sotëm për të përçuar aspekte historike mirëfilli, jo pak herë e shndërruan letërsinë shqiptare të duket vërtetë se ka sfond mirëfilli dokumentar. Por kemi një problem. Dhe, ky nuk mund të konsiderohet aspak i vogël. Arti s'është asnjëherë fakt dhe historia nuk mund të jetë kurrë fantazi, paçka se në Shqipëri nga problemi i identifikimit shumë e bëjnë letërsinë të duket histori me plot penegjirizma që e kanë modifikuar dhe vetë gjininë e bukur, kurse historinë që bëjnë shumë pseudo bashkë me shumë gjysmë-profesionistë, e kanë kthyer këtë zeje gati në fantazi, ngjashëm me letërsinë. Kjo të bën të mendosh për habitat e mëdha që na ofron letërsia jonë e këtyre kohëve që gati po e glorifikon Bilokun, po tregon histori gati të pabesueshme për masivizimin desident apo me kinset fantazitë e tjera, kinse persekutimet e shumë gjojave, që kanë zbehur realitetin problematika të vendit. Biloku, por jo vetëm, i cili prodhoi shumë prej të keqes në vend dhe më shumë akoma ishte përgjegjës për modelin e zgjedhur të zhvillimit të vendit, ka lënë shumë pasonjë, që gati po e shndërronjë krejt letërsinë në një narracion të ri, mbushur me histori të paqena.

Ka një ngushëllim po të kemi parasysh një moment Platonin. Sipas tij, arti është gënjeshhtë, e në këtë logjikë problemi zgjidhet deridiku. Allan A. Pasco në punimin e tij "Literature as historical archive" ("Letërsia si arkivë historike") mendon se: "Është e jashtëzakonshme sesa normale është bërë në ditët tona për historianët të sjellin romane, poezi, drama si ilustrime apo si burime". Në fakt, kjo është e vërtetë, por kjo lidhet me përmasat e letërsisë të caktuara. Do mjaftonte "Bretkosa" e Mo Yan që njerëzit të kuptonin shumë jo vetëm për Nobelistin kinez, por edhe historinë kineze dhe mes saj edhe për një nga problemet e saj më të madh historiko-social dhe zgjidhet e saj. Këtë atribut kuptohet se nuk mund ta bënte dot Letërsia Hispanike me Realizmin Magjik, por deri diku e arriti Letërsia Ballkanike me problemet e mëdha që shtroi. Përmes Ivo Andriç, ti njëj mekanizmi e brendshëm

Arti s'është përgjithësisht fakt dhe historia nuk mund të jetë kurrë fantazi, paçka se në Shqipëri nga problemi i identifikimit shumë e bëjnë letërsinë të duket histori me plot penegjirizma që e kanë modifikuar dhe vetë gjininë e bukur, kurse historinë që bëjnë shumë pseudo bashkë me shumë gjysmë-profesionistë, është kthyer gati në fantazi...



të Perandorisë Osmane dhe përfaqësimin e tyre dhe të huajve në Ballkan dhe rezistencën vendase përtej letërsisë. Kurse mëtonjësi i Nobel-it, shkrimtari më i madh shqiptar, Ismail Kadare, do t'i jepte një përmasë tjetër psikës së Perandorisë me një shtrirje gjeografike të letërsisë së tij nga Mesjeta deri në kohët tona. Kaxanaxiqis dha shpirtin e Ballkanasit grek me ndryshimet e kohës dhe mbijetesën përballë kushteve të këqija objektive dhe subjektive, mbushur plot me paradokse, duke mos kursyer negativizmat e shoqërisë dhe kritikën e ashpër ndaj fesë. Poetët ishin më larg historisë, por ata bënë gjëra më të vështira, pasi përmes figuracioneve përçuan perceptimin metaforik. Tani të besosh se kultura e ka shfrytëzuar letërsinë në këtë mënyrë për të dhënë historinë kjo është pak e vështirë, pasi i ngjan të shikosh historinë përmes një fejqyre letrare.... gjë që teoricienët e artit e shmangin disi.

Shumë nga autorët e brezit të sotëm të dytë, i kanë dhënë dimensione interesante letërsisë sonë, por deri ku ata i ka shtyrë memoria e kohës. Arian Leka punon shumë me fabulën e shqiptarit si Ballkanas, ashtu si Luljeta Leshanaku ka kërkuar që përmes metaforës së saj të përfaqësojë një publik më në hije, por gjithmonë me shumë veçanti dhe me kërkesa të larta. Një grup tjetër po prekin me kujdes historinë e Shqipërisë përmes shikimit nga jashtë ose retrospektivës.

Ndërkohë që mungesën më të madhe letërsia shqiptare e ka në vetë-përfshirjen e saj dhe sot ka nevojë për një histori që brenda të ketë një lloj "Vetting". Së pari, ajo duhet të jetë më dashamirë, sa i përket të gjithë autorëve, që kanë jetuar në Shqipëri apo jo. Duhet të jetë më integruar me autorët shqiptarë të Kosovës dhe ata të Maqedonisë. E, në të gjithë këtë qerthull, ajo patjetër duhet të bashkëpunojë me historinë dhe anasjell-

tas, për ta bërë të gjithën më të integruar, si edhe për përfshirjen e strukturës së kritikës letrare në të. Por pa e tepruar. Me pak fjalë, sot, letërsia shqiptare vuan nga paragjykimet dhe mbi të gjitha mungesën e një shtrati të përbashkët ku duhet të përfuset të gjithë letërsinë në arealin shqiptar. Për letërsinë tonë ka paragjykimet, e jo më kot, pothuaj po i fshihet periudha e Socializmit si edhe shumë aksesorë të tjerë, ndërkohë që sot ka ardhur koha që kjo letërsi të përfshihet në disiplinën krahasuese, e cila krahason pa kufij dhe me modele bashkëkohore.

Në një aktivitet në Prishtinë, studiuësja bullgare Rumiana Stanceva do të theksonte faktin që "specifika e marrëdhënëve letrare në Evropën Juglindore shpjegon sundimin kryesisht të disa tipave studimesh komparative në lidhje me fenomenet letrare ballkanike - receptimi letrar, imagjologia dhe studimi i paralelizmit në gjini dhe tematikë. Komunikimi në Juglindjen tonë nuk presupozon ndjekjen ose aplikimin e një modeli fqinjë. Informacioni këmbëhet në atmosferë të qetë, afër indiferencës". Ne mund të mësojmë më shumë duke bërë krahasime, por edhe duke parë veçantitë dhe mënyrat sesi bëhen të prekshme fenomenet letrare të Evropës Juglindore me ato të Evropës Perëndimore në histori dhe anasjelltas, apo kohën kur janë bërë të tilla. Shembulli më tipik është qëndrimi ndaj romanit vendas dhe kontributi që po jep në histori ky zhanër sot. "Gurët e vetmisë" së fundmi e Enkel Demit dhe "Fjala e fundit e Sokrat Bubës", e Thanas Medës janë nga shembujt më të këndshëm sesi letërsia ka zbardhur segmente historike, ashtu si Historia e thatë që hartohet shpesh nga autorët tanë i ka borxh ende letërsisë, ndoshta për shkak edhe të mungesës së duhur të aftësisë së njerëzve të historisë për këtë fakt. (Milosao)

## P

## POEZI

*Ky është një cikël që përmbledh krijimtari nga vitet 1982–1990, ku autori i është drejtuar jo thjesht vetëdijes, por lë të shpalosur dhe nënvetëdijen, duke dhënë shqetësimin e shqiptarit të viteve '80 dhe në kapërcyell të këtyre viteve...*



NGA XHEVAHIR SPAHIU

## MONOTONI

Shushurijnë shelgjet në fushë,  
shushurijnë;  
mërmërijnë mizat në mriz, mërmërijnë.

O zot,  
lësho një bubullimë.

1986

## ZEZONA

Ç'mënxyrë ia ul kokën  
asaj pishë që s'tundet?

Çdo ditë mbi të një sorrë shkon e ulet.

1982

## HISTORIA JONË

Tehut të shpatës kemi ecur rrufë.

Pastaj shpata ka ecur mbi ne.

1988

KOKA IME,  
ÇUDITEM ME TY

Koka ime,  
çuditem me ty.

S't'u shurdhuan ata veshë?  
S't'u verbuan ata sy?

Si të mban qafë e hollë?  
je mbi shpatulla ende?  
S'u mërzite aty?

Koka ime,  
çuditem me ty.

Të të merrja në duar  
të t'i prekja pak okët,  
ballin bërë për plumba;

Të të rrokja nën sqetull,  
gurë e drurë të këndonin:  
shkon njeriu kokëpreprë.

Në një këngë të moçme  
kjo ka ndodhur njëherë.

Po ti prapë si mushka  
mizorisht rri aty.

Koka ime,  
çuditem me ty.

1986

## ZEZONA

Ka muaj që duart e ngrata s'më punojnë  
dhe koka më bën dimër tej e tej;  
s'e di se nga më vijnë dhe ku shkojnë  
ca akuj kallur tinëz nëpër dej.

Çdo ditë gishtërinjtë i asin nikotinës  
ca fjalë uloke ... dhe ... sot... ashtu si dje;  
aq sa je gati me grusht t'i biesh pasqyrës,  
fytërin tënde ta rrëzosh përdhe.

Mungesa e vetmisë më ka munduar,  
tani i vetëm ndihem, si në morg;  
në se përshesh me kocka më kanë shtruar  
as korbit vetë unë nuk i ndolla kob.

Ngre kurthe ditënata; dimër vera  
shtrigon, mpreh thikat; ç'besëlidhje e zezë!  
Pas çdo rrënoje iluzionesh, era  
fryn, o njeri, mbi ty si mbi varrezë ...

dhjetor 1984

## PËRKTHIMI I LUMIT

Rri dhe përkthej lumin.  
Përkthim i vështirë  
ky i ujërave.  
Fjalë të rralla,  
shprehje të ngurosur,  
ritëm i tejkohëve.  
Njëqind burime njëzëri  
mitin e moçëm kallzonin.  
Gjithë natën përktheva lumin.  
Në mëngjes  
përkthimi ishte zhdukur.

Skrapar, 1983

## KOHË MODERNE

M'i morën shokët zyrat, aeroportet,  
simpoziumet ndërkombëtare,  
në skaj të kujtesës së tyre  
të tjera fytyra e kanë zënë vendin tim;  
a thua të ketë mbetur ndonjë humbëtitirë  
për mua  
në këtë marramendje harrimi?  
M'i morën shokët pa mëshirë,  
shihemi rrallë,  
rrallë e më rrallë pëqemi;  
më buzëqeshin maturisht prej tribunave,  
më përshëndesin uturimthi pas xhamave  
të

makinave,  
për Vit të Ri postojnë emrat në kartolina  
standarte,  
asin ndryshe,  
ndryshe hanë,  
pas drekave, darkave u kuqojnë faqet.  
Kanë lidhur krushqi,

i tundon horoskopi;  
kolltuku altar  
ku rri vetë Zoti.  
M'i morën shokët e më lanë cung.  
Mbi kohët arkaike një qiell i zbrazët  
dimri  
E bukur kujtesa,  
po më i bukur harrimi.

1989

## PYETJE E RREZIKSHME

Përtej ditares një qiell i heshtur.

Akuariumi i hënës  
pa peshkun.

Pa tringëllima guaskash  
që bishti pas qelqit i përplas  
e ëndrën ta lë pezull  
nëpër natën e nartë.

Dy sy fëmije lodronin rreth tij  
dhe në bebëz të syve një pyetje:

- Peshqit pse s'asin?

Pyetje e rrezikshme. Përgjigje  
enciklopeditë nuk japin.

1990

## NJERIU I PESTË

Macja hyri në shtëpi ditën e shtunë.  
Në fillim  
një hutesë. Fërgëllonte. I tërhuzej bishtit  
të saj sikur  
të ishte koka e një tjetri. Luante me ne a  
me veten?  
Gruaja i pakësoi përkujdesjet për burrin.  
Përkëdhelte  
shpinën e macës dhe thoshte ca fjalë, ca  
ninulla të  
hershme që dikur ia thoshte djalit në djep.  
Mua ma  
fkën cigaren: macja e do ajrin të pastër.  
Në shtëpinë tonë erdhi njeriu i pestë.  
Djali fle  
dhe macja i rri si një zanë mbrojtëse te  
koka. Macja u  
bë libër: Natyrë. Liri-demokraci për vete  
kërkon. A do  
të na japë nga një shpirt të ri prej shtatë  
shpirttrave të

saj?  
Rrotull shtëpisë sonë janë shtuar qentë.

1990

## SONTE

Jetoi brenda syve të tu,  
në sytë e mi ti ke shtëpinë.  
S'jemi vetvete,  
secili është tjetri.  
Vera ime ka dy skaje:  
njëri në pranverë, tjetri në vjeshtën tënde.  
Ti hyn në të djeshmen time,  
humb rrugën që ka humbur kujtesën.  
Unë hyj në të ardhmen tënde,  
humb rrugën si ai që në pyll s'ka kaluar  
asnjëherë.  
Sa do të doje të kishe në duar të djeshmen  
time!  
Sa do të doje të kisha në duar të ardhmen  
tënde!  
Kë të pyes? Cilin yll? Cilën kohë?

Për të djeshmen time ti mund të pyesësh  
një lumë,  
dy lisa, një dem,  
edhe varrin,  
varrin e nënës.

Krejt e kotë.  
T'i lëmë pyetjet. Pyetjet le të marrin një sy  
gjumë.  
Sonte jemi vetëm e sotme.

1989

## NATYRË E QETË

U ulëm të dy në tavolinën e zbrazët,  
si dy të panjohur të ardhur prej skajeve;  
unë nxora laps dhe letër;  
ai laps dhe paketën e cigareve.  
Unë shkruaja dhe fshija vargje,  
braktisur nga mendimi dhe fjala;  
ai tundte kokën, diku kish gabuar,  
nisi llogarinë nga e para.  
Kështu kaluan minuta të akullta,  
lapsat zukatnin përmbi tavolinë;  
tringëllimë rimash, qindarkash;  
unë në ndeshje me fjalët,  
ai me llogarinë.  
U ngritëm njëherësh, u pamë sy në sy;  
kush isha unë,  
kush ish ai?  
Dy të panjohur  
secili në rrugën e tij.



## ...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri ishte sërisht shumë e mirë. Ndrej Gjini solli një argument të shkëlqyer për historinë tonë, sipas të cilës Shqipëria mund të aplikonte shumë mirë rastin e Irlandës, për sa i përket shkrimit të historisë. Irlandezët ia kanë deleguar të drejtën e hartimit të historisë së tyre kombëtare një trupe shkencore të Oxford. Modeli irlandez mendoj se do të ishte i përshtatshëm për një vend si Shqipëria. E të mendosh se Irlanda ka përjetuar një pushtim gati 700- vjeçar nga Anglia. "Tekstet e historisë se këtij vendi nga vitet 1922-1923 e deri në mesin e viteve 1960 kanë vuajtur nga patetizmat, megalomanitë dhe shabllonizmat në favor rymave nacionaliste, apo nga e kundërta e tyre, në mënyrë ekstreme. Nëse do të ishte shkruar pak më mirë realisht do kishte vërtet impakt". Për fat të keq, Shqipëria në këto ditë është futur në një ngërç të frikshëm dhe askush nuk e pati mendjen për këtë shkrim interesant. Shkrimtari shqiptar Arian Leka erdhi me një tregim që e kishte botuar në antologjinë "A Good European" me titullin "Paranoja", përkthyer në gjuhën gjermane nga Zuzana Finger. Tregimi nënvizon idenë se liria ekziston si një premtime, por mungon në jetën e përditshme. Është interesant fakti se ai po përcjell tashmë frymën e shkrimit që e hasim shumë në gadishull. Nga ana stilistike kishte zgjidhje shumë interesante.

Vetë redaktori shtoi një argument për mundësinë e revoltës së artistëve. "Zhgënjimi i komunitetit të artistëve shtohet edhe për faktin e pagesës së trishtë, por edhe ajo që nuk është bërë gjatë qeverisë socialiste, e cila mëtoi në fillim me titullarët e saj dhe grupin drejtues të bënin një fushatë të gjerë për t'i takuar dhe folur nga afër me komunitetet. Por, gati gjashtë vjet më vonë nga mandati socialist, artistët, i frikësohen paq të ardhmes, që lidhet me frikën nga shkurtimet, kontratat, fakte që i bëjnë ta mendojnë çdo gjë ndryshe. Po a mund t'i bashkohen kësaj revolte, që po nis pak nga pak. Kjo mbetet akoma për t'u parë...". Në fakt, artistët janë zbehur pak para pakënaqësisë së madhe që ka kapluar të gjithë vendin.

Në stilin e tij të zakonshëm tejet epigramatik, Moikom Zeqo, autori i njohur, na ka sjell një cikël krijimesh të periudhave të tij të shkuara, ku një dashamirës i letërsisë mund ta shijojë gjerësisht përmasën e krijimtarisë së tij dhe figuracionet interesante.

Ndërkohë që Agim Janina na bën një përshkrim të librit të historianit të fotografisë, Qerim Vroni, fokusuar nga një foto e vjetër, në stilin e zakonshëm përshkruet dhe evidentues të cilësive. Layout punoi shumë mirë, paçka mungesës së redaktorit.

28 maj 1989

## VERBIMI

Mos më fol për Zakinion

Tak-tak trokiste mbi gurë  
shkopi i syve të verbër.  
Bota varrosur në bebëzat boshe,  
pa ngjyra,  
pa volume,  
si nata e përmbytjes së përbotshme.

Tak-tak. As dashuri. As urrejtje.  
Zjarr i fkur. Tak-tak. Kohë e palexueshme.  
Tak-tak. E përjetshme.

Zakino, ç'kërkon atje lart?  
Ti po shkel hijen tënde?  
Po për mua, ç'thonë për mua në botën e  
përtejme?

Me Zakinion apo natën et zëri njëherësh?

Ndërroja rrugë sa e shihja,  
nga verbëria e tij edhe eshtrat më dridhen.

Prej teje jam sulur si i verbri drejt dritës,  
faleminderit, Zakino.

1989

## NATA MBETI PËRJASHTA

Nata mbeti përjashta  
e tëra: me yjet, hënën, me terrin rreth tyre,  
lumi me zërin e ngrirë,  
drurët e veshur me heshtje.  
Nata mbeti përjashta  
tok me lakuriqët që shohin me veshë.  
Nata mbeti përjashta,  
kuis, shqyen ëndrra me nofullat e ashpra,  
në supe hijenash hedh mantelin e saj.  
Le të trokasë,  
çaponjtë t'i përgjaken,  
derën nuk ia hap.

## HAPPY END

S'është e vërtetë:  
Uliksi s'mbërriti kurrë në Itakë.  
Homeri me dorën e tij s'e ka shkruar;  
e shtuan redaktorët më pas.

1984

## BUKA JONË E PËRDITSHME

Ti erdhe pranë dhe më the:  
ta hëngra zemrën!  
Unë mbylla sytë  
dhe shpleksa ëndrrën.  
Shoh si përgjaket zemra ime  
në buzët e tua prej mishi dhe drite.  
Të bëftë mirë, e dashur.  
Po tani, tani, a s'më thua  
pa zemër, si mund të dua?  
Ti the dy fjalë,  
hodhe një gur:  
ta hëngra zemrën.  
Dhe unë i përgjakur numëroj  
rrathët e ëndrrës.  
E di: zemra ime  
zemrën tënde e ka bërë copë e çikë,

kullon gjaku prej saj  
si kokrrat e shegës, pikë-pikë.  
Ti the: Ta hëngra zemrën,  
kur unë fatziu e kisha sosur tënden.  
Ish koha e zisë  
dhe zemrat na u bënë buka jonë e  
përditshme.

17 gusht 1986

## NISJE PA KTHIM

Do të vijë nata, do të hyjë brenda meje  
në ca shtigje të verbër ku askush nuk ka  
shkelur,

do të ecë pa u ndjerë, në majë të  
gishtërinjve,  
si të shkelë mbi një ngrehinë prej qelqi,  
dita do tkurret pak nga pak si një  
mjegull,  
nata më në fund do të ketë emrin tim.

Do të nisem për udhë. E vetmja nisje pa kthim.

Vlorë, 2 gusht, 1989

## KALOJE URËN, JETA IME

Mbetë, jeta ime, mbetë

përtej Urës së Qabesë,  
shkoqur në rërën e zezë.  
Mbetë, dita ime, mbetë  
matanë lumit s'u hodhe dot kurrë.  
Andej ëndrra,  
këtëj trupi,  
s'u hodhe dot kurrë kënga ime, s'u hodhe  
dot

kurrë.

Më thua, nata ime, më thua,  
kaun e zi a e shitën,  
djalin, moj, djalin a e rritën?  
Po ajo gëzimzeza e ruan a s'e ruan  
kujtimin e burrit;  
eh, le të marthohet, çojani lajmin me zogitë  
e katundit.  
Po marthohem dhe unë, jeta ime, po  
marthohem

dhe unë,  
për dasmën time asnjë fjalë më shumë,  
asnjë fjalë mos u thua, asnjë fjalë më  
shumë.  
Nusja ime ka pamjen e plumbit,  
plumbit në kraharor; ëndrra ime e  
gjakosur,  
kënga ime, jeta ime brinjë më brinjë e  
plagosur.  
Nuse prej plumbi, kalë prej meiti,  
kalë potkonjrrënë,  
bobo, ec e gjeji potkonjtë nëpër rërë,  
nëpër rërë, fatkobi im, nëpër rërë.  
Ec, o kalë, kali im, kalë pa fre e pa shalë,  
kërkove kaprollin me brirë oriri,  
tani nëpër jele të vërtiten ca korba  
e ca hije bojëhiri,  
qyqja ti, zemra ime, korba,  
dil e prit krushq të zinj, dil e prit te porta,  
priti korbat shaluar mbi dhoga,  
po vijnë, mishi im, të t'i hanë sytë e zinj,  
sytë e zinj, zemra ime, sytë e zinj  
e ti të mos e shohësh atë nënë që qan në  
lëmë,

jeta ime,  
e ti të mos e shohësh atë motër që qan në  
kodër,

jeta ime,  
e ti të mos e shohësh atë grua që qan në  
krua,

jeta ime,

Kaloje atë urë,  
kaloje atë urë të mallkuar, shpresa ime,  
siç dridhesh ti, trupi t'i dridhet,  
po që se gremiset, nga ti të gremiset,  
e ty të të marrë lumi, varka ime,  
lumi të të marrë,  
të të shpjerë larg, udha ime, të të shpjerë  
larg,  
e ti t'i lësh pas  
terr e tmerr në ferr; koha ime,  
masakrime në dhë e në fe, t'i lësh pas  
siç lënë pluhurin karvanet.  
Brigjet ja tek janë;  
drejt teje aviten.  
Kaloje atë urë, vdekja ime e pabërë,  
jeta ime.

29 maj 1989





A

ARGUMENT

Në kokën e guslës malazeze, boshnjake, serbe, kroate gdhendet vetëm dhia dhe shqiponja e ikonografisë bizantine, ndërsa në lahutën shqiptare elementët shoqëruës të epikës legjendare, si gjarpëri shërues, ora - gjarpër që paraqitet me fytyrë njeriu, ora e maleve me tiparet misterioze të një fytyre elipsoide, vesh dhe sy jonjerëzorë, shqarthe, kafshë tepër e rrallë në Alpet shqiptare që mbron territorin e vet dhe e siguron atë veç për vete, pasi ndeshet me kafshët e tjera të malit dhe i mbyl, karakter i ngjashëm me vetë kreshnikët, që kujtohen në kreun e lahutës, siç thotë studiuesi Jaho Brahaj: Edhe në përjetësinë e shpellës o varrit nuk është një i vdekur i shtrirë, por gjallon i ulur këmbëkryq.

NGA LULJETA DANO

Në mendësinë shqiptare konvencionohet si Institucion i Lahutës dhe i Lahutarit, ajo çfarë rapsodi me instrumentin muzikor përfaqësojnë. Lahutarët shqiptarë këndojnë para gjindjes së vet farefisnore, pasi kjo është pjesë e rëndësishme e mënyrës së tyre të jetesës dhe jo, si këngëtarë me pagesë para një auditori të huaj, siç këndojnë guslarët sllavë. Lahutari di deri edhe dhjetë - pesëmbëdhjetëmijë vargje përmendësh.

Sipas Ramadan Sokolit, emri Lahutë vjen nga arabishtja *Al Ud* (druri i aloes). Në frëngjisht është: *leut*, në italisht: *liuto*, prej së cilës u mor nga shqipja dhe gjuhë të tjera emri i lahutës. Por ndoshta mund të jetë dhe një emër onomatopeik përbërë nga dy lëvizjet e harkut: llah dhe hutë.

Më i vjetër në moshë, rreth pesë mijë vjeçar instrumenti më popullore i Indisë: *Ravanstron* - i (*Ravanahatha*). *Ravanastron* - i bëhet si dhe lahuta nga druri i arrës së kokosit, me lëkurë dhie dhe qime kali. Mendohet se *Ravanstron* është nëna e tërë instrumentave kordofonë: violinës, violëlës, violonçelit, stringës, kitarës, kontrabasit.

Vetë lahuta është vegla kordofone më e vjetër arketipale evropiane.

Mjeshtrit e rapsodive dallojnë disa mënyra interpretimi me lahutë: Në Malësinë e Madhe teli i vetëm akordohet fort, tingulli i saj mbizotëronte zërin e këngëtarit, i cili togun zanor të fundrreshtit e zgjat. Kurse në Dukagjin, rapsodia është e shtruar, e butë në të kënduar, zëri i këngëtarit që del mbi lahutën dhe formula e hapjes është karakteristike e Dukagjinit: *Lum për Ty, o Zot, i lumi Zotynë/Që s'jem kanë, e Zoti na ka dhanë!*


Një mënyrë të kënduarit është kur shtohet gjatësia e fjalës së fundit të vargut duke zgjatur rrokjet dhe lihet një rrokje për rreshtin pasardhës. Kjo sjell dhe bashkimin e rreshtit të fundit të strofës së parë me vargun e parë të strofës së dytë.

Rapsod është term i studimeve të letërsisë orale, në të folmen popullore rapsodi quhet Lahutar.

Çdo kullë detyrimisht duhet të kishte lahutarin e vet, sepse "*Shtëpia pa lahutë, asht shtëpi e lanun*", dhe çdo lahutë e vjetruar nuk duhej të hidhej o digjej, por ngjitej në trarë e çatisë së kullës që të rrinte bashkë me shpirtin e të parëve të fisit për të bekuar e mbrojtur pasardhësit, shkruan hulumtuesi i etnografisë, Jaho Brahaj. Lahutari çohet më shpesh dasmor - krushk se burrat e tjerë, respektohej më fort në bankete e në udhë, preferohej më shumë të zgjidhej kumbar për fëmijët e porsalindur.

Mjeshtërbëresit shqiptarë të lahutave në ndërtimin e instrumentit muzikor zgjedhin drurin e arrës ose të panjës për kupën e drunjtit në formë vezake me bisht të gjatë.

Druri pritej në dimër, kur në kapilarët e drurit nuk qarkullonte lëndë ushqyese, pritej me hënë të vjetër, në mot të kthjellët pa asnjë re, ku nuk frynte pikë ere, sepse këto papastërti do t'i prishnin kthjellësinë e këngës. Pastaj druri lihej të thahej



## LAHUTA DHE LAHUTARI, SI INSTITUCION



mbi trarë pranë oxhakut për një apo dy vjet. Nga cungu i arrës së vjetër dyngjyrëshe të bardhë dhe të errët merrej vetëm zemra e errët që nënkuptonte një kohë edhe më të hershme, gdhendej me majë të brisikut (biçakut) duke i dhënë formë me një tel të skuqur në zjarr. Kupa vishet me lëkurë nga barku i dhisë ose i kecit. Maniakë të rrallë pas tingullit absolut të pastër kanë përdorur lëkurë maceje. Harku i lahutës bëhet me degë thane e tërhequr nga të dy krahët nga një "tel" i bërë nga disa qime nga bishti i kalit (mëz-it) të pashaluar në vitin e parë të jetës, jo të pelës. Mbrapa në krye të kupës së drunjtit ngjitet një masë rrëshire pishë, të cilës para njesjes së këngës i vihet flaka për të temperuar "telin". Gjithashtu lahuta ngrohej pranë zjarrit për të hequr lagështirën.

Gjatësia e përgjithshme e modelit au-



C

CMIMI

# “The price of Glory” i Meksit në World Press

Karikatura shqiptare do të përfaqësohet në World Press me punën e fundit të Arben Meksit, të titulluar “The price of glory”. Aktiviteti, i cili po zhvillohet në Portugali, përmblodh punët më të mira në disa gjini të Arteve Pamore dhe synon të përcjellë krijimet më të mira të vitit 2018, nga shumë artistë të njohur.

Arben Meksi, në vazhdim të abstragimeve të tij tejet interesante, ka zgjedhur një punë me një simbolikë shumë interesante disi zoomorfe, ku dreri vajton humbjen. Duket si një punë që me këtë simbolikë përmblodh dy kohë të ndryshme, pasi nderimi i zgjidhur me formën monumentale, ka një dimension tjetër të pedestalit, që përshfaqin brirët e drerit në formë dekorimi. Duhet vlerësuar abstragimi jo thjesht teknik i stilit por edhe gjetja brenda gjinisë grafike, që Arben Meksi e zhvillon në mënyrë shumë kanon-

ike. Ai është i rezervuar ndaj elementit të theksuar piktorik dhe ia lë zgjidhjen e tematikës së tij, piktorës shumë të pastër karikaturore, ku çdo detaj ka një funksion për ta bërë idenë sa më të plotë. Përndryshe, Arben Meksi, duket se mendon shumë para se ta hedhë, por e realizon punën gati me një frymë, sepse puna i rri në kokë. Ndaj, kanonet çëdojnë rrallë ose atëherë kur ai vetë s'është i bindur për krijimin e duhur.

Nëse do të vlerësohet në një aspekt më ndërkomëtar, puna e tij hedh dhe një vështrim për lavdinë e dikurshme të shumë dukurive që lidhen me civilizimin e sotëm, por edhe të vlerave të përbotshme, që tashmë u ka mbetur vetëm vajtimi. Kjo punë e ekspozuar e tregon më së miri këtë paradoks.



tentik të lahutës shkon përgjithësisht cm. Peshat rreth kg. Lahutës i konsumohet lëkura, ose e hanin minjtë, kështu që i ndërrohet shpesh lëkura gjatë jetës së saj si lahutë e gjallë që shkonte edhe me qindra vjet.

**Gdhendjet dekorative** tek lahuta kanë një larmi të pabesueshme, mbetje e një sistemi simbolik pagan, figura mitologjike e legjendare. Një nga kryeveprat është lahuta e vizatuar nga H. Schtackelberg, më 1917, me një begati të jashtëzakonshme figurash, ndoshta tërë mitologjinë që lidhet me përdeshën Athina.

Në kokën e guslës malazeze, boshnjake, serbe, kroate gdhendet vetëm dhia dhe shqiponja e ikonografisë bizantine, ndërsa në lahutën shqiptare elementët shoqëruar të epikës legjendare, si gjarpëri shërues, ora - gjarpër që parqitet me fytyrë njeriu, ora e maleve me tiparet misterioze të një fytyre elipsoide, vesh dhe sy jonjerëzorë, shqarshi, kafshë tepër e rrallë në Alpet shqiptare që mbron territorin e vet dhe e siguron atë veç për vete, pasi ndeshet me kafshët e tjera të malit dhe i mbyk, karakter i ngjashëm me vetë kreshnikët, që kujtohen në kreun e lahutës, siç thotë studiuesi Jaho Brahaj: *Edhe në përjetësinë e shpellës o varrit nuk është një i vdekur i shtrirë, por gjallon i ulur këmbëkryq.*

Simbole të tjera gjeometrike që janë primatë të sistemeve simbolike, si palma, rrrathët bashkëqendrorë në fronin e lahutarit, spathija, të bashkërenditura në qafën e një lahute dalin një grumbull trekëndorësh të gdhendur si shkri-mi kuneiform, merimanga, ogursjellëse e mirë për shëndet e pasuri, zogu që duhet të nënkuptojë shqiponjën me gjarpër shoqëruar, janë mbyllur në një varg rombesh ku duan të na shfaqin një tërësi kuptimi dhe fuqi mbrojtëse për njerëzit dhe shpirtat rreth lahutës.

Shënime

Falenderoj, z. Zef Bari nga Dukagjini për konsulentën personale në lidhje me ritin e zgjedhjes së drurit, bërjen e lahutës dhe mënyrat e interpretimit të lahutarit.

Lahuta dhe Lahutari si Institucion është pjesë e essësë mbi Eposin legjendar të Veriut: ZGJEDHJA E DUHUR E GJETO BASHO MUJIT, nga Luljeta Danu, Tiranë, 2012.

R

REVIEW

NGA JOHN BRADLEY

“Mësuesja ime e parë/ e shqiptoi dy herë gabim mbiemrin tim./ Ishte therëse si një gjilpërë./


Një gjilpërë në llapën e vogël të veshit. Dhe krejt papritur/ pashë qartë/ pashë poezinë./

*fshihen e përkryer pas anonimatis.*” shkruan Luljeta Lleshanaku, në përfundim të poezisë së saj “Akupunkturë”. Poezia si “maskim”, padyshim ofron një mjet mbijetese për cilindo që kishte fatin të rritet në Shqipëri gjatë regjimit tiranik të Enver Hoxhës, sikurse edhe autorja. Po ama, vëreni dhuntinë tjetër që na blaton “pickimi” i gjilpërës: është kthjelltësia. Ky tipar e bën të rëndësishëm librin “Negative Space”, vëllimin e tretë poetik në anglisht të publikuar nga “New Directions” të Luljeta Lleshanakut. “Negative Space” lindi nga dy vëllime të papublikuara në anglisht më parë, dhe pikërisht nga “Pothuajse dje” dhe “Homo Antarcticus”, dhe i ofron lexuesit dyzet e shtatë poezi.

Kthjelltësia mund të ketë shumë trajta. Një syresh, të paktën në poezinë e Lleshanakut, është prania e vargjeve aforistikë, që dëshmon një mëncuri të përfutur nga përvoja të vështira. Ja, disa shembuj: “Asgjë nuk ekziston deri në momentin e mungesës”, “Njerëzit tregojnë për çfarë kanë/ por jo se çfarë janë”, “Të keqes nuk i dilem me gjoks/ E keqja mori fund vetë.” Një trajtë tjetër e kthjelltësisë në këto poezi, janë vërshimet e krahasimeve, gjithmonë unike dhe të paharrueshme. Edhe kur nxirren jashtë kontekst, ato ndriçojnë, si psh ky nga poezia “Duhani”, ku bishtat e cigareve përshkruhen si “gëzhoja/ dëshmi të një luftime pa lavdi/ të një luftë civile.” Ja dhe një krahasim tjetër mahnitës nga poezia “Muzikë live”, që përshkruan dy frekuentues pubesh: “Ata ndodhen këtu pikërisht për vri-

Mbi librin “Negative space” të Luljeta Lleshanakut, përkthyer nga Ani Gjika, dhe botuar nga shtëpia botuese “New Directions, në Shtetet e Bashkuara, në vitin 2018.

## “Negative space” e Lleshanakut



mat./ vrimat e mëdha në një klub amatoresk/ si brenda një buke artizanale me kore të lëmuar/ që ta bëjnë të lehtë qenien.”

Krahasimet e kthjellojnë dhe njëkohësisht i japin thellësi vargut. Ky element, mund të krijojë përshtypjen e një poezie abstrakte. Përkundrazi, në fakt këto poezi bazohen pothuajse gjithmonë në një ngjarje apo në një objekt krejtësisht konkret, si psh: një libër i përdorur i mbushur me shënime, një klasë mësimi historie, fqinjë që ndërtojnë shtëpi, ose edhe diçka po aq e rëndomtë sa shkallët. Në poezinë e saj të titulluar “Shkallët”, gjejmë një formë artistike që Lleshanaku e përdor shpesh në këtë libër, ku poezia nis me një konstatim të drejtpërdrejt: “Im atë ishte i fiksuar pas shkallëve,” dhe pastaj menjëherë ndryshon perspektivë: “Dhe ai trau i hekurudhës, me shiritat verdhë e zi,/ nuk është më nepërka që të ngjeth mishin.” Pastaj poezia zhvendoset në një lloj tjetër shkallësh, tek eskalatorët, duke kryer një kërcim metaforik: “Poezia gjithashtu ishte një mënyrë për t'u ngjitur;/

joshje përmes mohimit./ via negativa.” Kjo zhvendosje nga e zakonshmia tek e thella, ky hop i sigurt intuitiv, bëhet pa forcim, pa pretendim, dhe na kujton vepra të poetëve të tillë si p.sh. autorën nobeliste polake Wislawa Szymborska.

Përkthimet e Ani Gjikes në këtë vëllim krijojnë iluzionin më të rrallë, atë që këto poezi duken si të krijuara origjinalisht në anglisht. E tillë është natyrshmëria e vargjeve, siç mund të konstatohet në këtë ekstrakt nga poezia “Një ditë e përkryer”: “Po pastaj çfarë? / Çfarë ndodh pastaj? / As vetë nuk e di./ Dhe për drejt,/ në maj dita është e gjatë.”

Amaz një të metë e ka “Negative Space”: i mungon një parathënie me disa të dhëna biografike për autorin, që do të ndihnin në shtimin e lexuesit të saj këtu në Shtetet e Bashkuara. Po kjo është e parëndësishme për një libër, që është si “një re e ngjeshur baruti/ në një zonë të përkohshme armëpushimi.”

**\*Përktheu artikullin: Luljeta Qafoku**

T

TREGIM

NGA FARUK MYRTAJ

Mbaruam tharjen e kënetës, si rrallë më parë po gëzo hesha për punën fizike që kisha bërë, por e ndjeva lagështirën e ujërave thellë në eshtrat. Nuk po ecja dot lirshëm por, edhe kjo për herë të parë, sikur po më gëzonte pamundësia për të ecur. Përkisist pas kësaj ndodhi diçka që kurrë s'do ta harroja. Më nxorën nga spitali i të burgosurve me një karrocë të fisme, siç isha përpjekur të mbahesha edhe vetë, deri aty nga fundi i Luftës. Më kthyen në një qeli tjetër. S'po guxoja dot ta quaja qeli. Në atë hapësirë sado të vogël kishin vendosur një radio dhe një raft librash, ku binin në sy disa fjalorë të gjuhës së huaj për shkak të cilës isha dënuar. Mund të vështroje si qelë murgu e shumta, por kurrë si ajo skuta e errët e mëparshme, nga ku më kishin marrë kokë e këmbë për t'u përmendur në spital. Mbase nga që po e merrja veten fizikisht, në këtë hapësirë po ndjehesha si genie me fat të kthyer. Edhe pse ai, Gjeta, gardiani, ishte atje, te porta...

Vite më parë, më ndaluan diku pas mesnate, teksa prisja një bukuroshe që s'do më shfaqej kurrë më. Për disa ditë më mbyllën në bodrumin e një kështjelle në Jug, ku dëgjoheshin dallgët e detit të botës së madhe që e rrihnin nga jashtë, si për t'u ankur për mbylljen time aty. Më pas, më nisën mes qindra të tjerëve për tharjen e kënetës më të madhe në vend. Gjatë tërë kohës, bluaia në mokrat e mendjes për të kuptuar atë që kishite ndodhur, atë që mund të mos ndodhte nëse do kisha dëgjuar atëbotë ca miq të sërës sime që më kishin paralajmëruar se ca si shumë shoqërohesha me të huajt. Po si mund të bëja përkthyesin pa qenë më të huaj, pyesja unë, deri atë ditë kur më ndaluan edhe të përktheja. Kjo më trishtoi edhe më shumë, por së paku ishte logjike, kishte kuptim. Duke ma ndaluar përkthimin, s'kisha pse i takoja të huajt. Si për të më shpëtuar nga mëkati, apo për të më shpëtuar nga bashkëpunimi me ta, të huajt nuk u panë më në qytet. Dilja sërish në rrugë, për qejfin tim; orët e vona më kishin ngelur ydhër që nga djallëria ime, por as kjo nuk vazhdoi gjatë: më ndaluan, sërish prej gjuhës së huaj, që ishte gjuhë e atyre që ikën, domethënë, e armiqve...

Si për të më rikthyer në kujtesën e kohës, si përdorues i po kësaj gjuhe, fjalorët e së cilës ma rrëmbyen syrin nga rafti i qelës ku më transferuan pas spitalit, më nxorën edhe prej andej. Mbase isha i vetmi i burgosur në këtë dynja që liroheshin me detyrimin të përktheja. Jam po aq i vërtetë kur them se as që e kisha pritur këtë ftesë. Jo thjesht ngaqë asnjëherë s'pres të më ndodhnin gjëra që vijnë lehtë, ngaqë i dua, nga që i shpresoj apo ëndërroj për to. Jo! Nuk e besova që pikërisht mua të më besojë, më cuditshëm akoma, të isha i detyruar të përktheja librat më të rëndësishëm të kësaj kohe. Mbase jo rastësisht, do përktheja pikërisht ata libra që u gjenden në qelinë time të re. M'u bë lehtësisht e qartë: edhe nëse nuk i pëlqej këto libra, edhe nëse s'bija në një mendje me çfarë shkruhej në to, edhe nëse s'ishin librat që do pëlqejja t'i përktheja, sigurisht do t'i sillja në atë gjuhë që, po aq çuditërisht, më avitej herë si bekim e herë si mallkim, thjesht pse kishte ndodhur ta mësoja si gjuhë fëmijërie dhe hovesh djalosharesh...

Nuk m'u desh kohë ta mendoj ofertën. Ata duket e dinin, që s'kisha zgjedhje tjetër, veç të thosha 'po'. Madje, ta filloja menjëherë punën. Nuk isha aq i marrë sa ta refuzoja këtë "liri me kusht", lirinë me kondicional,

Autori bën një abstragim duke futur si tematikë persekutimin, por zgjidhur në një sfond jo shumë të ngjitur ndaj tij, zgjidhur diçka si persekutim të vetë qenies.

# BEJLURÇINA IM



si këmbim i vetmisë së të burgosurit me mbylljen e përkthyesit. Le ta harroja ç'kishte ndodhur, aq më pak që kishte ndodhur për shkak të gjuhës së huaj, përdërisa mund t'i kthehesha dhe t'i gëzohesha sërish po kësaj gjuhe. Po, u thashë, domethënë, librat që duhen përkthyer më pëlqejnë, gjithnjë më kanë pëlqyer. Mbase vërtet më besuan ç'u thashë, mbase e merrnin me mend sesi do tingëllonin, si do lexoheshin ato, të shkruara në gjuhën e huaj, përmes ndërmjetimit tim. Mbase i besuan edhe etjes sime për t'u gëzuar lirisë, lirisë me qdo kusht.

Nuk nënshkruam ndonjë kontratë. Ata nuk e zunë n'goje. Unë, thjesht e shkova ndërmend, si rravim të ca realiteteve që duheshin fshirë edhe nga kujtesa. "Ç'kontratë o njeri, i thashë vetes. Me shkresa, ti je ende atje brenda. Për ty, mjaft që s'je në burg."

Sa për kronikë, lirimim im kishte ndodhur edhe më thjesht se izolimi. Nuk kisha kryer as gjysmën e dënimit, por po më nxirrnin. Nuk më shpallën të pafajshëm, asnjë dekret faljeje nuk më përfshiu. Këtu s'ka ministri drejtësie, avokatët s'janë banorë të këtij vendi, s'erdhi ndonjë prokuror të më kumtonte fakte a prova të reja, që do të mund të rihapnin kërkesën për pafajësinë time. Asgjë nga këto. Gardiani, fytyrën e të cilit e shihja përditë, e vetmja pamje nga jashtë burgut; ai që më shoqëronte tri herë në ditë deri në banjë dhe kthim, ai që më sillte ushqimin si gjithë armiqve të tjerë; Gjeta pra, që be-tohej se "po t'ia linin atij në dorë, do t'i mbyste tërë armiqitë e këtij populli të vuajtur e fukara, pra edhe mua që kisha mesazur gjuhë të huaja armike. Ky Gjete hapi portën prej shufrash hekurit ndryshkur nga lagështia dhe, si të bënte të parën e të fundit shaka me mua, filloi

të më bërtiste e të më klithte:

"Akoma s'ke dalë, ti maskara?! Dil po të them! Dhe lutju Zotit tënd që shefat s'më lanë të të mbaja këtu, deri sa ta harroje deri në shkronjën e fundit atë gjuhën e huaj që thonë e ditke aq mirë sa... Dil të thashë! Tani! Në shkresat e qeverisë s'figuron që je këtu, s'paska fare dosje për ty. Të kanë harruar sapo të kanë sjellë këtu brenda, qysh ditën kur ikën të huajt. Vetëm unë e ditkam që ti je gjallë... Ik, dhe mos i thuaj kujt se ke qenë në burg, more vesh?"

Mbeta pa gojë. Më shkoi ndërmend ta përgafoja Gjete, por ia pashë sytë të rreptë, hodha ca hapa në drejtimin që ai shënoi, me ato duart si panxha arushes. Atje jashtë, përtej portës së rëndë të burgut, m'u prenë këmbët. Ktheva edhe një herë kryet pas. Gjeta s'dukej më. Nisa të besoj se s'kishte punë me mua, së paku herë për herë. U ula diku në një gur të ngritur.

Tashmë, isha edhe më i pasigurt nëse vërtet, tri net më parë, një bukuroshe më ishte shfaqur në ëndërr. Në atë ëndërr, qelia ime kishte pamjen e një zgavre shkëmbore në raniesthin anëditi. Vasha që m'u shfaq kishte trup të hajthmë e sy të ujshëm. E adhurova në cast, si bukuroshet e salloneve dikur. Gjithnjë kisha fluturuar pas veshjeve të tejdukshme, ashtu i kundroja, edhe kur ishin të veshura verbër. Unë njihesha si djaloshi që bija në dashuri me të gjitha. Edhe më e kollajshme m'u duk kjo bukuroshkë e fundit, dhe në qeli kërbohe ëndërrës; aq më shumë që komunikoi në të njëjtën gjuhë që kishte shkruar fatin tim. Gjithnjë ëndërrisht, më solli ndërmend se mund të merreshim vesh pikërisht në këtë gjuhë të huaj, duke u marrë, së toku, me përkthime. Aty ku ishim, kudo të ishim, do mund të ndjeheshim bashkë, të dy, të lirë. Qesha me zë të lartë në ëndërr, si të më premtonte jeta dikurshëm. Në gojë e Gjetës ëndërra ishte zyrtarizuar.

Prita që ajo të shfaqej me ndonjë makinë të fundit, aty përballë oborrit të burgut, dhe të më fonte të fluturonim që andej. Mbase pikërisht ajo djallushkë do të më tregonte çfarë do këmbëhej si kusht lirie, që unë të besoja se Engjëlli im vërtet ishte kthyer. E përse të mos i isha mirënjohës qoftë edhe kësaj lehtësie femërore, vjegë e varur mbi lumin në të cilin për pak isha duke u mbytur...

Për të bërë përkthyesin, pothuaj gjatë tërë kohës rrija mbyllur. Ngrihesha hera-herës dhe dilja në dritare, gjithnjë pas perdes, sa të merrja frymë më gjerë dhe të çmijja shpinën prej përkuljes së gjatë mbi makinën e shkrimit. Në fund të ditës, vonë fare, çlodhesha në cast kur kujtoja veten që s'isha në burg. Punoja fort, e lodhshme kjo që bëja, por ishte ajo çfarë kisha shkruar ndërmend të bëja edhe në ditët më të bukura. Përktheja, tek e fundit, s'bëja punë krahu, s'ishte tharje kënetë, dë. Përkthimi, gjithsesi, ishte kënaqësi, lezet, eglendisje, ca më shumë për mua. Njëllorji si në sallonet, dikur. Të merresha me libra, të flisja për libra, të kisha të bëja me njerëz të kënduar, kjo kishte qenë ëndërra...

Përktheja çdo ditë shtatë-tetë faqe nga "Tharja e Kënetës", gjë që po më pëlqente. E lëshoja veten në hapësira që dukej se i kisha harruar. Pa qëllim, pa e kuptuar, e kapa veten duke u përpjekur të marr me mend se si do pritej përkthimi im, si do lexohej... andej... ku kisha qenë dikur. Kisha ende ca miq, që me siguri do të kujtoheshin, sapo të shikonin emrin tim si përkthyes. "Ku paske humbur, mirë që u ktheve", do thoshin, të tjerë do më shkruanin, do më ftonin, do më...

"Përkthe, bëj punën tënde ti... thaj kënetën tënde, atë bëj!", ia mbylla menjëherë gojën vetes. "Ç'të duhet ty se ç'do të ndodhë më tej me përkthimet e tua?"

Edhe thjesht të menduarin për këto gjëra ishte mirë ta ndërprisja. Ta heshtja në cast mendimin që më prasi në shtigje të tilla... "Nëse s'të ka marrë malli të kthehesh sërish në ato baltërat e kënetës ku mikun tënd sa nuk e lanë të zhytej, ku, për pak, e lanë të humbiste nën thithjen e llumit të zi të kënetës. Hesh, pra, ktheje vetminë në virtyt, në gjuhën e kënaqësi ktheje, që të mund të mbetesh i shpërblyer, përkthyes i kësaj vetmie të madhe", i thashë vetes. E çfarë do bësh ti, nëse ata harrojnë dhe i botojnë librat pa emrin e përkthyesit? Do kërkosh kontratë? Do rikthehesh në qelinë apo në qelinë tënde, më thua dot?

Së paku të mos ia hedhësh fajin gjuhës së huaj sërish, pastaj. Tanimë mund ta pësosh prej vetes, jo prej lirisë që ke jetuar dikur. Nëse atë të shkua dot duhet ta mbaje larg, siç edhe fizikisht, larg atyre trojeve, të sotmen thjesht do duhet ta shkundësh, ta përmendësh, ta zgjosh, siç të ndodh ndonjëherë edhe me pulpat e këmbëve të zbuluara të bukuroshëve. Mos u shty deri atje sa të shprehesh se edhe dashurinë si eglendisje do duhet ta harrosh, edhe në nuancën të shuterese të sinonimeve, të mos guxosh ta quash veten jo të lirë, përdërisa tashmë... s'je në burg.

E çfarë pastaj se do bëhen vite, kur më në fund do jesh shndërruar në murg manastresh. Ti tashmë e ke pranuar se asgjë s'mbetet, nëse jo prej përvaajtjes së thellë... Kjo është puna jote, or qyq, i thashë vetes. I dënuar me kusht je...

Përdora të njëjtat fjalë, të më në fundme, të gardianit Gjetë. "M'u hiq sysh edhe ti, bejluurçina im!"



Opinion i Ditës

# Fjala që s' mu dha në kuvendin e Partisë Demokratike

Nga Bislim Ahmetaj

(vijon nga faqja 1)

... për të thënë, por do të mundohem të jem i kursyer, sepse më dhimbset koha juaj, koha ime, për ta harxhuar brenda mureve të kësaj sale që bart histori sa të mira aq edhe të këqija. Sepse vendi im, vendi juaj, vendi i çdo intelektual dhe veprimtari politik që nuk i ka futur duart në xhepat e qytetarëve të vendit të tij është në sheshin e protestave që kanë shpërthyer në të gjithë Shqipërinë. Prej kohësh jam etiketuar si kritik i Bashës, bile edhe mbrëmë nëpër rrjetet sociale emri im këtë etiketë kishte. Nganjëherë më humor, por edhe me sarkazëm më quajnë "armik", me këtë termin e dytë jam rritur, term që më ka burrruar para kohe dhe më ka pajisur me guxim e kurajë që të përballoj çdo sfidë në jetë.

Unë s'jam, as kam qenë ndonjëherë kritik i personit Lulzim Basha, por i veprimeve dhe mosveprimeve të tij si kryetar i Partisë Demokratike dhe opozitës, veprime që kanë sjellë një apati dhe çoroditje, një mjedis dëshpërues, një realitet të errët, ku shpresa dhe besimi janë vrrarë, një gjendje dramatike në mjedisin politik shqiptarë dhe veçmas atë opozitar.

Shqipëria nga qeverisja kriminale e Edi Ramës dhe çetës së tij, nga mungesa e besimit dhe shpresës tek lideri i opozitës po shndërrohet me shpejtësinë e dritës në një azil gjigand pleqsh.

Po vazhdoj kjo gjendje s'do jetë e largët dita që polici i rrugës do jetë edhe infermier, edhe mësues, edhe kujdestar social i moshës së tretë.

Unë thjesht kam artikuluar ato që ndjehem dhe perceptojnë shumica juaj në këtë sallë dhe në këtë vend.

Unë jam thjesht interpret i atyre që dëgjojnë ditë për ditë në kafenë e PD-s, nga bashkëpunëtorët e tij të selisë qendrore dhe atyre lokalë, nga demokratët e thjeshtë, nga qytetarët e zakonshëm që janë të irtitur nga varfërimi dhe mungesa e dritës në fund të tunelit.

Unë kam qenë, jam dhe do të jem kritik i çdo mendimi dhe veprimi, i kujtdo qoftë, i cili cenon lirinë, pengon zhvillimin e demokracisë, që mbyt mendimin ndryshe dhe flirtin me Edi Ramën dhe bandën e tij në kurriz të demokracisë dhe lirisë, në kurriz të shqiptarëve të ndershëm në kurriz të pengimit të Shqipërisë për t'u bashkuar me ëndrën e bashkëkohësve të mi të viteve 90 "E duam Shqipërinë si gjithë Europë".

Zonja dhe zotërinj.

Themelet dhe muret e shtëpisë së demokratëve janë të shëndet-



shme, të forta dhe të sigurta. Ato u ngjizën në DHJETOR të 90-ës, në ato themele është kontributi i jashtëzakonshëm Azem Hajdarit, Arben Brocit, Abdyl Matoshit. ESH-TË kontributi i Sali Berishës, Gramoz Pashkos, Leka Meksit, e Pjetër Arbnorit.

Është kontributi im dhe i dhjetëra studentëve, intelektualëve, qytetarëve të Tiranës dhe gjithë Shqipërisë që ishin pjesa e mor-

alshme dhe e pastër e lëvizjes studentore në dhjetor të 90-ës.

Muret e kështjellës së demokratëve janë po aq të forta dhe të sigurta. Mijëra anëtarë të saj në të katër anët e vendit me ndershmërinë dhe përkushtimin e tyre lanë kontribuar në vite që këto mure të jenë vlerë e çmuar kombëtarë, ata janë të gatshëm siç e kanë treguar kur kanë mbushur sheshet me 300 e 400 mijë

vetë ta flakin në errësirë këtë qeverisje kriminale që ka pushtuar vendin tonë, që e ka diskredituar Shqipërinë dhe shqiptarin në vendin e vet dhe jashtë saj.

Çatia e shtëpisë së demokratëve apo lideri që e ka drejtuar deri sot për mua, por besoj edhe për shumicën tuaj që jeni në këtë sallë është e kalbur, pikon, s'ngjall shpresë, s'afion siguri.

Marrëveshja e 17 majit dhe produktet e saj që ishin zgjedhjet e qershorit 2017 e ka mbuluar me dyshime dhe pikëpyetje dëshpëruese lideri apo çatinë e Partisë Demokratike.

Sot çatia e demokratëve i ngjet një plake zdrukthi të ngopur me ujë.

Një miku im, por edhe i shumëve prej demokratëve që ne e thërrasim Xhaxhka me humor këtë që thashë unë me lart e ka përmbledhur me urtë në një fjali: Teqeja është e mirë, besimtarët flori, Babai i teqesë nuk ma mbush syrin.

Zonja dhe zotërinj, demokrat të çmuar, ju që ju dhimbset Partia Demokratike, ju që ju dhimbset më shumë se gjithçka Shqipëria është koha të bëhemi serioz dhe t'i fshijmë të gjitha meritët, meskinitetet dhe cic-micet që na ndajnë,

sot është dita të zgjedhim lisat prej të cilëve do të nxjerrim dërrasat me të cilat do të mbulojmë çatinë e kalbur të Shtëpisë së Demokratëve.

Sot, djë këto dhjetë ditë të shkuara vendi i çdo demokrati, vendi i çdo shqiptari të ndershëm është aty ka po lind një shpresë e re, në sheshet e protestave. Jo për të sjellë Partinë Demokratikë dhe një grusht njerëzish në pushtet, por për të sjellë një ndryshim të madh.

Ka qenë e natyrshme kjo lëkundje besimi nga Berisha tek BASHA, unë e kam thënë këtë në një shkrim në gazetën "Panorama" sapo ka ndodhur zëvendësimi i tyre, ai shkrim mbante për titull "Anija e PD-s ka nevojë për rrentarë dhe jo për kapiten" pasi Berisha kishte stil tjetër udhëheqës dhe Luli tjetër. Unë kam shpresuar dhe besuar që Basha do të drejtojë PD-në dhe opozitën me ekip, këtë shpresë e kam pas bazuar tek edukimi i tij perëndimor. Kjo shpresë dhe ky besim m'u ka ndryshkur, sepse akoma s'është shfaqur.

Unë jam idealist dhe njëkohësisht poet, për pasoj shpresën se humb kurrë, e iluzionoj atë, i jap afate të reja, unë e projektoj dritën edhe në errësirë. Le të shpresojmë që të mos jetë vonë për atë vet, për Partinë Demokratike dhe për Shqipërinë.

Për mbyllje...

Këto 10 ditë unë kam qenë çdo ditë pranë studentëve.

Së pari, si prind i dy djemve studentë, së dyti, si pedagog në njërin prej universiteteve publike të vendit, së treti, si njeri i angazhuar politikisht, si qytetar i revoltuar.

Askush s'më ka refuzuar, përkundrazi më kanë mirëpritur dhe më kanë kurajuar t'iu jap mbështetje, t'iu jap besimin tim dhe të brezit që sollin ndryshimin.

Liri dhe Demokracia që sollin DHJETORI i 90-ës është konsumuar plotësisht. Jemi në kufijtë e një demokracie. Është koha dhe momenti historik të rrezojmë nomenclaturën apo oligarkinë politike që ka prodhuar kry tranzicion që zgjati gjatë, plotë 28 vite. Në këtë sallë ka fajtorë për këtë gjendje. ËSHTË koha për ndryshimin e madh. Këtë ndryshim le ta nisim që sot në këtë kuvend në mënyrë që me votën tonë t'i vëmë Shtëpisë së Demokratëve çatinë që meritonjë themelet dhe muret e saj.

Ju faleminderit!

Opinion i Ditës

# Pakti i Migracionit dhe përçar(t)jet nacionaliste

Nga Jorgji KOTE

(vijon nga faqja 1)

... një Migracion të Sigurt, të Organizuar dhe të Rregullt" (GCM) Ai vjen në vijim të Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në korrik 2016, si reagim ndaj megakrizës së azilit që shpërtheu tre vite më parë. Për këtë qëllim, në prill 2017 filluan negociatat nën kujdesin e OKB-së dhe në Korrik 2018 të gjitha vendet anëtare miratuan projekt-tëksin e këtij Kompakti që u paraqit në Marrakesh këtë javë. Rëndësia e tij për të gjithë, përfshirë dhe vendin tonë, për shkak të ritmeve të larta të azilit dhe migracionit qëndron në faktin se për herë të parë, OKB-ja tenton të rregullojë dhe menaxhojë azilin dhe migracionin në një plan global si tri sifdat më të mëdha të kohës bashkë me ndryshimet klimatike. Ai kompaktëson qasjen dhe ligjet lokale, rajonale, kombëtare dhe botërore; me 23 objektivat e tij për rregullimin dhe menaxhimin e azilit/migracionit të ligjshëm, garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të azilkërkuesve, goditjen e rrjeteve kriminale dhe të trafikimit, përshtetimin e procedurave të integrimit të tyre në vendet pritëse, etj.

Kompakti nuk është ligjorisht i detyrueshëm, çka e lehtëson mjaft pozitën e shumë vendeve ku forcat populiste, ekstremiste dhe anti-migratore janë në pushtet ose ushtrjnë trysni të madhe mbi qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare. Ai është një arritje e shënuar e OKB-së, sidomos po të kihet parasysh përshkallëzimi i kësaj krize gjatë 20 viteve të fundit, kur numri i azilkërkuesve është rritur 50 për qind; ndonëse 258 milionë emigrantët e huaj përfaqësojnë vetëm 3.4 për qind të popullsisë së botës, numri i tyre pritet të rritet me shpejtësi për shkak të faktorëve të njohur politikë, ekonomikë, demografikë, konflikteve dhe luftërave të përgjakshme, krimet e korrupsionit, etj. Veç kësaj, si pasojë e moszbatimit të konventave ndërkombëtare, nga viti 2000 kanë humbur jetën 60.000 emigrantë dhe vetëm këtë vit janë mbytur/zhdukur 3300 azilkërkues. Nisur nga paqartësitë juridike, hezitimet dhe kundërshtimet në disa vende, sidomos pas përshkallëzimit të prirjeve/përçarjeve nacionaliste, populiste dhe anti-migracion, miratimi i këtij Kompakti që do të votohet në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së më 19 Dhjetor ishtë rasti më i mirë për të treguar mirëkuptim, solidaritet dhe bashkëpunim më të madh ndërkombëtar; për të shesuar diferencat dhe dallimet dhe për të paratur një udhërrëfyes universal për trajtimin dhe zgjidhjen e qëndrueshme të krizës së azilit.



Me të drejtë u vlerësua si arritje fakti që në Samitin e Marrakeshit dhanë pëlqimin e tyre solemn përfaqësuesit e lartë të 164 vendeve, ku spikatin Gjermania, Franca, Britania e Madhe, Spanja, Kanada, Belgjika, etj. Gjithsesi, suksesin e lartpërmendur ndjeshëm kundërshtimi nga 30 vende të mëdha dhe me peshë, sidomos SHBA-të, Brazili, Kili, Australia, etj. Madje, Presidenti amerikan Trump një vit më parë akuzoi OKB-në se "po përpiqej të avancojë qeverisjen globale në dëm të të drejtës sovranë të shteteve". Në fakt, siç u përmend dhe më parë, kur lexon përmbajtjen e Kompaktit, sheh se kritikë dhe përçarjet populiste ndaj tij nuk i përgjigjen realitetit, sidomos lidhur me cenimin e sovranitetit të vendeve dhe të drejtën e tyre. Por, paralelisht me to, duke njohur vështirësitë dhe specifikat e azilit dhe emigracionit, Kompakti përcakton dispozitat e duhura globale për trajtimin dhe bashkëpunimin shumëpalësh në këtë fushë me ndjeshmëri të lartë. Gjithashtu, ky Kompakt shmang "futjen në një thes" të azilkërkuesve viktimë të gjendjes në vendet e tyre me elementë kriminelë dhe terroristë.

Kancelarja gjermane Angela Merkel në fjalën e saj të pritur me entuziazëm pohoi se migracioni i rregullt është gjë e mirë. Ajo theksoi se "Ky kompakt është përgjigja më e mirë ndaj nacionalizmit pur dhe tregon se rregullimi i azilit dhe emigracionit në kuadrin e OKB-së nuk është asgjë më pak se themeli i bashkëpunimit tonë ndërkombëtar". Rëndësinë e multilateralizmit ajo e ilustroi bindshëm kur tha se mbi tërë dekadë më parë, Gjermania ra preh e populizmit dhe ekstremizmit nacionalist, duke i hapur rrugën nazizmit që e çoi botën në kasaphanën e

dytë botërore. Për fat të keq, plasaritjet në këto tri vitet e fundit ndërmjet disa vendeve anëtare të BE-së, në Marrakesh u kthyen në përçarje të hapura. Themi kështu se shtatë vende anëtare të BE-së janë kundër Kompaktit Global: Austria që mban dhe presidencën e BE-së, Çekia, Sllovakia, Letonia, Hungaria, Polonia dhe Sllovenia; ndërkohë, Italia, Bullgaria, Estonia, por dhe Zvicra me Izraelin nuk kanë vendosur ende, por më tepër duken kundërshtarë. Ndërkohë, dhe ndonjë vend që ka dhënë pëlqimin, po has në kundërshtime dhe presion të madh nga forca të brendshme nacionaliste. Tipik është rasti i Belgjikës, ku ditën që u miratua Kompakti nga qeveria e Kryeministrit belg Charles Michel, aleatja e tij më e madhe partia me prirje nacionaliste N-VA u largua nga koalicioni qeveritar, duke e lënë vendin me qeveri pakice e duke rrezikuar zhvillimin e zgjedhjeve të parakohshme. Gjithashtu, forcat ultranacionaliste kanë paralajmëruar këtë të diel një marshim të madh proteste kundër Kompaktit të Marrakeshit dhe emigrantëve, por që nuk është lejuar nga Bashkia e Brukselit. Ja pse, prania dhe fjala e Charles Michel në Samitin e Marrakeshit u prit me ovacione, ashtu si e Kryeministrit spanjoll Pedro Sanchez, etj.

Përçarjet brenda BE-së për këtë çështje që mund të zgjidhet vetëm me bashkëpunim shumëpalësh janë shumë shqetësuese kur mendon se fillimisht vendet kundërshtarë ishin aktive dhe mendimet e tyre u muanë parasysh në hartimin e tekstit të Kompaktit; për më tepër, ky i fundit nuk është i detyrueshëm, ai merr parasysh rregullat dhe interesat e vendeve kombëtare dhe plot elementë të tjerë. Po pse atëherë ky

**HOROSKOPI**

**DASHI**

Në punë nuk duhet të ndërmerrni shumë rreziqe dhe shmangni situatat që mund t'iu dëmtojnë. Para çdo hapi që do hidhni duhet të mendoheni mirë. Në dashuri gjithçka shkon normalisht.

**DEMI**

Ndigni intuitën në situata të vështira dhe çdo gjë do të zgjidhet. Sot do filloni të bëni disa ndryshime në jetën sentimentale. Në punë nuk do keni shumë fat, por nuk duhet të mërziteni.

**BINJAKET**

Në punë nuk do të mungojë xhelozia, e cila duhet tejkaluar sa më shpejt. Hap pas hapi do të zgjidhni të gjitha problemet e jetës sentimentale. Gjithçka do shkojë mirë sot.

**GAFORJA**

Do ndjeheni të lumtur. Përfitoni sa më shumë nga kjo ditë! Ka ardhur momenti të gjeni një punë që i përbush të gjitha kërkesat tuaja. Fati do ju buzëqeshë sot.

**LUANI**

Në punë ndjeheni plot energji për të marrë vendime të rëndësishme. Jeni të vendosur dhe mendoni gjithmonë se çdo pengesë kalohet me këmbëngulje dhe diplomaci.

**VIERGJERESHA**

Priten ndryshime në jetën tuaj sentimentale. Në punë do mendoni për disa projekte të reja. Të gjithë do ju inkurajojnë dhe do ju përgëzojnë për idetë origjinale që keni.

**PESHORJA**

Një surprizë e këndshme do ju shtojë të ardhurat. Në punë duhet të vazhdoni projektin e nisur. Për problemet që keni kaluar nuk e ka pasur gjithmonë fajin partnerin.

**AKREPI**

Në dashuri do të keni shumë fat sot. Çdo gjë është e mundur për të lindurit në shenjë tuaj. Do jeni entuziaste dhe gjithçka do ju duket shumë e lehtë. Ditë vërtet shumë e kënaqshme.

**SHIGJETARI**

Në sektorin profesional duhet të mendoheni dy herë para se të merrni një vendim. Sa i përket jetës romantike, nuk do ju mungojë sharmi duke tërhequr vëmendjen e të njerëzve që pranë.

**BRICJAPI**

Në punë nuk duhet t'i lini vendimet për nesër, sepse do jetë vonë. Bëni kujdes me shpenzimet e tepruara. Personi që keni në krah do jetë një burim frymëzimi sot.

**UJORI**


Do të ndjeni afeksinon e partnerit, i cili më shumë se kurrë do të jetë pranë jush. Kjo gjë do ju bëjë ditën më speciale. Në punë duhet të analizoni me kujdes çdo mundësi që ju del përpara.

**PESHQIT**

Do ju nevojitet më shumë kohë për një projekt që keni nisur. Mos e humbni durimin, sepse gjithçka do të stabilizohet brenda pak ditësh. Në dashuri, fati do jetë në anën tuaj.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Roland ... i një turneu tenisik.
6. Eshhtë përshtatja.
12. Lidhjen brigje.
13. Eshhtë lëndë helmuese luftarake.
15. Binjaket në klasa.
16. Eshhtë rozë me gossip.
18. Ente Grumbllimi Tiranë.
19. Gjysma e sfidës.
21. Rossi në MotoGp.
24. Qe përmindësh në labirint.
26. Gjysmë rebusi.
28. I famshëm ai i Anne Frank
29. Fillojnë tatëpjetën.
30. Ishte anestetik i parë.
32. Gjysmë ironik.
33. Bates që qe aktor.
35. Eshhtë sport me stil të lirë.
37. Poet i famshëm rus.
39. Luahen në teatër.
41. Një bluzë sportive.

42. Diftong poetik.
43. Tre në Arlington.
44. Sorel aktor
46. Me to bëjnë torta.
48. Janë gjakxehtë.
52. Ekstre në lëng.
53. Mund të jetë franceskan.
54. I ndjeri Pascal i Pirandello-s

**VERTIKAL**

1. Hiddink trainer.
2. Mbyllin një sirtar.
3. Një pije e jona.
4. Rotor pa zë.
5. Mimar arkitekti i famshëm me origjinë shqiptare.
6. Kryejnë veprime pagesash.
7. Këndonte me Supremes.
8. Mbyllin fushatat.
9. Të fundit në shtëpi.
10. Intriganti i Otello.
11. Eshhtë shahu i fundit.
14. Manovron me cloche.
17. Ishte poeti i metamorfozave
18. Pak enigmatike.
20. Janë për të shkruar nxënësit.
22. I ka tek truri.
23. Inicialete e Reitman.
25. Një pjesë e kandidatëve.
26. Janë nurat një dhe dy.
27. Ndjek një alfa.
29. Vuante etjen e përjetshme.
31. Kërkohej nga poeti.
33. Kanë ura dhe kuvarta.
34. Ashtu si kërkon të blejë kopraci.
36. Një sportist në pistë.
38. Inicialet e Harris aktor.
40. Eshhtë mballomë.
45. Parafjalë prejardhjeje.
47. Fillojnë afrimin.
49. Në fillim të vitit.
50. Të fundit në provim.
51. Fillojnë kalimin.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Përhapet me frikë.
6. Kreshniku i volejbollit.
12. Një mund të jetë unik.
13. Ekstre për naif.
15. Pak praktike
16. Mbyllin një manastir.
17. Vrau Hektorin.
20. I ka tek litri.
21. Një pjesë e gastareve.
23. Skudra e Bergamos.
26. Mund të jetë sitcom në Tv.
29. Janë porositë e fundit.
31. Gjysmë krenar
33. Një që jeton i vetmuar.
34. De Niro aktor.
37. Kufijtë e Tailandës.
38. Fund dhjetori.
39. Safin tenist.
40. Në fund majtas.
41. Demek s'ka kufij.

**VERTIKAL**


43. Ekstre në tenis.
44. Mbyllin një spital.
45. Qendër kurimi.
46. Joplun që qe këngëtare.
47. Emri i Zola.
49. Fillojnë ritmin.
50. Gjysma e etheve.
51. Tafili i interpretuar nga Timo Filoko.
52. Skudra bardheblu.
53. Janë veglat.
1. Fillojnë poshtë.
2. E famshëm ajo e Noes.
3. Fillojnë natën.
4. Tiran pa kufij.
5. Priset nga përçarja.
7. Me të nxjerrin një tapë.
8. Nuk duhet një e tillë.
9. Mbyllin porta.
10. Një mund të jetë fetar.
11. Opera e Mascagni-t.
14. Kanë gjuhë përvëluese
18. Eshhtë laps.
19. Pinci i Dy herë mat.
20. Janë të ndarë nga feja.
21. Qëllojnë me çifte.
22. Ylli në Hollywood.
24. Inicialet e Moravia-s
25. Inicialet e Dreiser.
27. Mund të jetë kinetike.
28. Gjysmë arrest.
30. Lionel, asi i futbollit.
32. Eshhtë hidrokarbur.
34. Në radhë të parë.
35. Janë topat katastrofikë të dëborës.
36. Janë pëlhura vere.
39. Mund të jetë solemne në kishë.
41. Braktisi Didonën.
42. Eshhtë legjenda.
44. Gjysmë alarmi.
48. Institucione Ndërkombëtare Ekonomike.
49. Inicialet e Redford.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOK**

5	2		9			3	4
6		4				8	1
		9	1		8	3	
8							5
		2	5		9	6	
9		5			4		7
2	1		3			6	9

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

9	1	8	6	3	2	7	4	5
3	5	2	7	4	9	6	8	1
4	7	6	5	8	1	2	9	3
6	8	9	1	5	4	3	7	2
5	2	7	8	6	3	9	1	4
1	3	4	2	9	7	5	6	8
2	4	5	9	1	6	8	3	7
7	9	1	3	2	8	4	5	6
8	6	3	4	7	5	1	2	9

*Argëtim filozofik*

"Nuk jam i sigurt nëse jeta jonë është e ndryshme nga jeta e njerëzve që shpëtojimë. Ne të gjithë kemi një fund. Ndoshta asnjëri prej nesh nuk mund ta kuptojë plotësisht atë që ka jetuar në të kaluarën, ndoshta asnjë prej nesh nuk mendon se koha që duhej ishte e mjaftueshme".

Nuk më pëlqen sekretet e të tjerëve. Por më interesojnë rrefimet e tyre.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

14	1	3	9	16	13		5	8	16				
5		14	5	3	5	4	7	10	2	8	4	2	
13	5		15	5	10	5	9	1	4		5	11	
1		15	2	10	1	4	2	15	1		6	1	
1	16		2	4	4		5	9	1	5	4		
10	5	17	H		2		6	5	3	8	5	4	
12	11	5	A	9	9	18	5	8	4	5			
3	4	15	K		1		4	4	4		4	5	13
3		16	T	12	17	5		2	3	16		6	2
1	10		11	5	13	15		5	3	2	1	9	
4	2	18	5	3	1	4		4	3	16	3	2	

M	I	K	E		K	M		S		E
E	K	A		R	O	M	A	K	E	T
K	M	I	L	I	T	A	N	T	E	T
M	A	T	E	M	A	T	I	K	A	
P	A	S	A	N	I	K		T		S
E	K	U	A	N	E	T	A	R	E	T
R	E	T	E	E	I	R	A	N	I	
I	T	R	B	L	A	K	E		L	
M	I	A	R	E	D		E	K	I	
E		M	E	T	A	L	E		I	S
T	E	K	E		M	K	U	M	T	
M	O	R	A	V	I	A		M	A	E

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQIJE TË NUMRIT TË KALUAR**

A	R	K	A		A	S	T	R	O		A	M	A
D	I	A	N	A	H	E	M	T	R	A	T	E	
A	T	L	A	N	T	I	K	E		G	L	S	
P	E	I	T	A	R	I	F	A	T		L	E	
T	I	T	P	O	L	I	T	I	K	A	N	E	T
		K	E	N	E	I	A		Q	R	A	R	
P	A	U	L	I	N		R		R	I			
A	K	E	O	T		A	A	D		D	I	M	
R	U	M	U	N	E	K	I		E	R	A		
E	T		I	E	R	I		A	M	A	N		
T		E	I		G	R	D	I	A	N	E		
I	N	T		A	R	O	M	A		E	I	T	

P	A	B	M	E	L		E	R	G	O			
R	K	U	P	A		E	M	T	R	A	T	E	
O	H	A	R	A		D	A	R	O	M	A	I	
K	C	I	K	L		M	E	T					
S	T	A	D	I	M	E	T		A	P	E	L	
D	I	K	A	S	T	E	R	E		R	U	E	
D	K	E	N	T		N	G	O	P	I	E	V	
K	A	T	I	A	S	I	E	E	S				
A	R	N		I	O		L	A	I	R			
M	A	S	S	I	M	O		Z	A	N	O	R	E
A	M	A	N		A	N	N						
T	T	E	R	R	E	N	T		E	I	N	E	

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

*Thënie të mençura*

- Nevoja e botës duhet të trajtohet intelektualisht dhe shpirtërisht, jo emocionalisht.
- Aspekti moral i jetës është një fushë shërbimi, jo një fushë e perceptimit sensual.
- Kini kujdes jo vetëm për tendencat tuaja të gabuara, por edhe për përdorimin e virtuteve tuaja.
- E kaluara garanton zgjerimin e pakufizuar të së ardhmes.

